



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
DREJTORIA E TARIFAVE DHE ÇMIMEVE**

**RELACION
MBI SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË PËRDITËSUAR PËR TARIFAT E
OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËNDARJES PËR VITIN 2022**

Bordit të ERE-s

Këtu

Të Nderuar Anëtarë të Bordit,

Në zbatim të nenit 19 gërma c), pika i) të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti përgjegjës për miratimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

ERE me vendimin e Bordit nr. 182, datë 10.11.2017, ka miratuar “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike”, e cila ka për qëllim përcaktimin e parimeve, kushteve dhe procedurave të tarifave të përdorimit të rrjetit të shpërndarjes mbi bazën e parimeve të llogaritjes së këtyre tarifave duke vlerësuar të dhënat e domosdoshme për një tarifë të drejtë.

Gjithashtu, referuar pikës 1, të nenit 21 të Rregullores për “Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin nr. 96, datë 17.06.2016 të Bordit të ERE-s, i licensuari që kërkon përcaktimin/rishikimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin pasardhës, jo më vonë se data 1 Shtator të vitit aktual, duhet të paraqesë në ERE një kërkesë me shkrim të shoqëruar me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj rregullore dhe metodologjive përkatëse.

Aplikimi i paraqitur duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës sipas parashikimeve të nenit 22 të Rregullores për “Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, të Bordit të ERE-s dhe “Sistemit të njëhsuar dhe të standartizuar të llogarive për të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 244, datë 26.11.2018.

- Bazuar në detyrimet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, shoqëria OSSH sh.a. me shkresën nr. 8016 prot., datë 03.09.2021 (protokolluar me tonën me nr. 925 Prot., datë 07.09.2021) ka depozituar në ERE, aplikimin për shqyrtim të tarifave të OSSH sh.a. për vitin 2022.
- Në vijim të shpalljes së gjendjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike me VKM në Nr. 584, datë 08.10.2021 dhe VKM Nr. 620, datë 22.10.2021 “Per miratimin e kushteve të vendosjen e shërbimit publik ndaj të licensuarëve në sektorin e

energji elektrike gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin e energji elektrike dhe për plërbullimin parandakimin e saj”, gjendur në kushtet e ndryshimeve të menjëhershme të parashikimeve, shoqëria OSSH sh.a. me shkresën nr. 8016/1 prot., datë 30.09.2021 (Protokolluar në ERE me Nr. 925/1, datë 04.10.2021), ka paraqitur në ERE kërkesën për përditësim të aplikimit të sipërcituar.

- Në kuadër të një vendimarrje sa më të drejtë, me shkresën Nr. 925/2 Prot, datë 11.10.2021, ERE i ka kërkuar OSSH sh.a përditësimin e të dhënave të aplikimit duke ju përmbajtur specifikimeve të VKM-së Nr. 952/2, datë 11.10.2021, mbi shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, si dhe plotësimin e kërkesave thelbësore sipas përcaktimeve të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes”.
- Ndërkohë shoqëria OSSH sh.a. me anë të shkresës Nr. 8016/3 Prot., datë 18.10.2021 (Protokolluar në ERE me Nr. 925/3, datë 20.10.2021), ka depozituar në ERE aplikimin për tarifa të OSSH sh.a. për vitin 2022.
- Pas shqyrtimit paraprak të aplikimit të mësipër nga Drejtoria e Tarfave dhe Çmimeve, me relacionin Nr. 144/4 Prot, datë 17.11.2021, bazuar në nenin 11, nenit 19 germat “c”, “i” dhe nenit 20 të ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 15, 19, 21 dhe 22 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 182, datë 16.11.2017, grupi i punës i propozoi Bordit të ERE-s fillimin e procedurës për shqyrtimin e Aplikimit të shoqërisë OSSH sh.a, për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për vitin 2022.
- **Bordi i ERE-s me Vendimin Nr. 233, datë 19.11.2021, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të tarifave të OSSH sh.a. për vitin 2022.**
- Aplikimit si dhe dokumentacioneve plotësuese të paraqitura nga OSSH sh.a. janë publikuar në faqen elektronike www.ere.gov.al sipas afateve të përcaktuara në “Rregulloren për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”
- Në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të ERE-s nr. 87, datë 03.12.2021, u zhvillua një seancë teknike midis përfaqësuesve të ERE-s dhe të shoqërisë OSSH sh.a. ku u diskutua mbi procesin e shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës së OSSH sh.a. për vitin 2022.
- Më tej, mbështetur në “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, ERE ka vijuar korrespondencën me shkresën nr. 925/5 Prot., date 26.11.2021, përmes së cilës i është kërkuar shoqërisë dhënia e informacioneve, argumentave dhe dokumentacionit justifikues mbi pyetjet dhe paqartësitë e lindura nga shqyrtimi i aplikimit për përcaktimin e tarifave të OSSH sh.a për vitin 2022.
- Pas shqyrtimit të korrespondencës së sipërcituar si dhe në kuadër të pyetjeve të lindura gjatë seancës teknike, me shkresën Nr. 925/8 Prot, datë 15.12.2021, ERE i ka kërkuar OSSH sh.a dhënien e informacionit, argumentave dhe dokumentacionit justifikues për efekt të ruajtjes së parimit të transparence si dhe për marrjen e një vendimi sa më të drejtë dhe kosto reflektues.

- Ne vijim, OSSH sh.a me shkresën Nr. 10691 Prot., datë 14.12.2021, protokolluar me tonën me nr. 925/9 prot., datë 15.12.2021 ka paraqitur në ERE materiale plotësuese në lidhje me aplikimin për tarifa OSSH sh.a. për vitin 2022.
- Në mbështetje të nenit 22, pika 6, germa a) të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”. me shkresën Nr. 1139/7 Prot, datë 16.12.2021, ERE i ka kërkuar OSSH sh.a informacion në lidhje me përmbushjen e detyrimit ligjor të shoqërisë për njoftimin e publikut brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike mbi masën e ndryshimit të tarifave dhe çmimeve si dhe përqindjen e ndryshimit të tyre për çdo klasë dhe grup konsumatorësh, me anë të publikimit të aplikimit në jo më pak se dy tre gazeta me qarkullim në nivel vendi, apo në zonën ku aplikuesi siguron shërbim.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr 252 date 21.12.2021 vendosi te shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 213, datë 15.12.2020, deri në përfundimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OSSH sh.a. për tarifën e shpërndarjes së energjisë elektrike për nivel tensioni për vitin 2022, në mënyrë që shoqëria të mundet të realizojë aktivitetin për të cilat është licencuar, konform dispozitave të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.
- Në përputhje me pikën 7, të nenit 22, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, ERE zhvilloi më datë 29.12.2021 një seancë dëgjimore publike me përfaqësues nga shoqëria OSSH sh.a. si dhe nga palët e interesit, ku u diskutua në lidhje me aplikimin për përcaktimin e tarifave së OSSH sh.a. për vitin 2022. Në përfundim të seancës, shoqërisë ju la detyrë përgjigjia me shkrim mbi çdo paqartësi ose pyetje të evidentuar nga ana e grupeve të interesit.
- Me anë të postës elektronike, ardhur në adresën erealb@ere.gov.al dt 29.12.2022, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë citon se *“janë kundër ndryshimeve që qeveria parashikon të ndërmarrë duke nxjerrë në tregun e parregulluar 7500 siper marrje dhe ndaj kërkesave të shoqërive publike të energjisë për ndryshimin e tarifave”*.
- ERE me shkresën nr. 177 Prot, datë 26.01.2022, ndër të tjera i ka kërkuar shoqërisë sërish informacion, argumenta si dhe dokumentacion justifikues në lidhje me çështjet e evidentuara në korrespondencën e sipërcituar. ERE solli në vëmëndje të OSSH sh.a. se, duhet të dërgoheshin në ERE pasqyrat financiare të plota të vitit 2021 shoqëruar me një raport analitik të shpenzimeve operative të realizuara për secilin grup shpenzimi, parashikimet e OSSH për vitin 2022 si dhe përlllogaritjet së bashku me informacionin mbështetës në të cilin ishte mbështetur propozimi i OSSH sh.a. për çmimin e faturimit të energjisë reaktive.
- OSSH sh.a. me shkresën nr.11226/2, datë 04.02.2022 iu përgjigj shkresës së ERE nr. Nr. 925/8, datë 15.12.2021 ku ndër të tjera ka bashkëlidhur një pjesë të materialeve plotësuese të kërkuara nga ERE në lidhje me aplikimin për tarifa OSSH sh.a. për vitin 2022.
- OSSH sh.a me shkresën Nr. 1451 Prot, datë 15.02.2022, i propozoi ERE-s organizimin e një seance teknike, ndërmjet përfaqësuesve të OSSH sh.a dhe ERE-s, për sqarimin dhe detajimin sa më të qartë të të gjithë informacionit të përcjellë prej saj.

- Me shkresën Nr. 801/1 Prot, datë 22.02.2022, OSSH sh.a. ka sqaruar arsyet e mos dërgimit të informacioneve të kërkuara si dhe sqarimet përkatëse sa i takon çmimit të propozuar të energjisë reaktive duke kërkuar nga ERE
- Në vijim të kërkesës së paraqitur nga OSSH sh.a. me shkresën Nr. 1451 Prot, datë 15.02.2022, ERE zhvilloi seancën dëgjimore teknike, më datë 09.03.2022, me përfaqësuesit e Shoqërisë.
- ERE me anë të shkresës Nr. 237/8 Prot, datë 18.03.2022, në përgjigje të sqarimeve të OSSH shprehu konstatimet e saj lidhur me mangësitë e evidentuara në informacionet e përcjella nga Shoqëria me shkresat Nr.11226/2 Prot, datë 04.02.2022, dhe Nr. 801/1 Prot, datë 22.02.2022.

Theksojmë se pas depozitimit të aplikimit protokolluar me Nr. 8016/3, datë 18.10.2021 (me tonën Nr. 925/3, datë 20.10.2021), të përditësuar sipas specifikimeve të përcaktuara në VKM në Nr. 584, datë 08.10.2021 dhe VKM Nr. 620, datë 22.10.2021 “*Per miratimin e kushteve te vendosjen e shërbimit publik ndaj te licencuarëve në sektorin e enrgjise elektrikegjate gjendjes se emergjences ne furnizimin e energjise elektrike dhe për plërballimine parandakimin e saj*”, në korrespondencat e shkëmbyera më tej, shoqëria ka përcjellë në ERE rillogaritjen e të ardhurave të kërkuara. Këto rillogaritje janë reflektuar në ndryshimin e tarifës mesatare të shpërndarjes së energjisë elektrike 2 (dy) herë brenda periudhës së shqyrtimit të aplikimit.

Në vijim të përditësimit të aplikimit dhe sqarimeve të kërkuara nga ERE, shoqëria OSSH sh.a. me shkresën nr. 11226/1, datë 02.02.2022, ka deklaruar se nga përlllogaritjet e kryera me informacionet e përditësuara, tarifa mesatare e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022, kërkohet 6.69 lekë/kWh. Tarifat e shpërndarjes për nivele tensioni sipas përlllogaritjeve të përditësuara të OSSH sh.a. janë kërkuar si vijon:

a) Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022 në tensionin 35 kV prej 2.62 Leke/kWh nga tarifa prej 1.5 Lekë/kWh në fuqi

b) Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022 në tensionin 20/10/6 kV prej 4.14 Lekë/kWh nga tarifa prej 3.9 Lekë/kWh në fuqi për nivelin e tensionit 20 kV.

c) Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022 në tensionin 0.4 kV prej 7.37 Lekë/kWh nga tarifa mesatare e shpërndarjes prej 4.79 Lekë/kWh në fuqi, e cila ka shërbyer për nivelin e tensionit 0.4 kV.

Gjatë këtij procesi janë shqyrtuar të gjitha korrespondencat, të dhënat dhe dokumentat e përcjella për të përlllogaritur tarifa sa më të drejta, të arsyeshme dhe kosto reflektuese për ushtrimin e aktivitetit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Në vlerësimet e parashtruara në këtë relacion janë konsideruar kostot operative dhe kapitale të arsyeshme, të matshme dhe reale në zbatim të parimeve të vendosjes së tarifave mbështetur në Ligjin 43/2015 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*” i ndryshuar, “*Metodologjisë e llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike*”, miratuar me Vendimin Nr.182, datë 10.11.2017 të Bordit të ERE-s si dhe “*Manualit të llogarive për qëllime të rregullimit të shoqërive të licencuara në sektorin e energjisë elektrike*”, miratuar me Vendimin Nr. 244/2018

të Bordit të ERE-s.

Nga shyrtimi I aplikimit, korespondencave te deritanishme si dhe materialeve plotesuese te derguara në ERE ne kuader të zhvillimit të këtij procesi, paraqesim në vijim konstatimet dhe vlerësimet për sa përcjellë nga OSSH sh.a duke evidentuar dhe diferencat në vlera për çdo element të të ardhurave të kërkuara:

- **Shpenzimet operative dhe kosto e blerjes së humbjeve**

Në tabelën në vijim paraqesim krahasimet dhe diferencat midis aplikimit të përditësuar si dhe konsiderimeve tona për nivelin e çdo grup shpenzimi të shoqërisë për vitin 2021:

Shpenzimet operative dhe kosto e blerjes së energjisë						
Zëri	Miratur nga ERE 2015	2020 FAKT	OSHEE 2021 PARASHIKIM	OSHEE 2022 PARASHIKIM	ERE 2021	ERE 2022
Shpenzime Operative	7,884,000	8,502,990	10,554,511	10,741,467	8,808,353	9,072,104
<i>Shpenzime materiale dhe konsumi</i>	241,000	695,413	295,800	304,674	295,800	304,674
<i>Shpenzime per personelin</i>	3,384,000	4,753,607	5,050,122	5,201,625	4,896,215	5,043,102
<i>Mirembajtje</i>	2,476,000	1,498,026	2,676,504	2,756,799	1,400,000	1,442,000
<i>Shpenzime kolaudim matësa</i>					750,000	772,000
<i>Sherbime korporate</i>			1,259,831	1,167,947		
<i>Marredhie me publikun dhe marketing</i>	49,000	32,464	3,000	3,090	33,438	34,441
<i>Qera</i>	233,000	148,635	331,849	341,804	153,094	157,687
<i>Sherbime postare dhe komunikimi</i>	178,000	21,413	15,146	15,600	15,146	15,600
<i>Shpensime teknologjia e informacionit</i>	23,000	49,237	10,000	10,300	10,000	10,300
<i>Shpenzime liqjore</i>	148,000	87,049	1,000	1,030	1,000	1,030
<i>Konsulenca deh auditimi</i>	255,000	80,356	50,000	51,500	82,767	85,250
<i>Te tjera</i>	897,000	1,136,790	861,259	887,097	1,170,893	1,206,020
Kosto e blerjes se energjise	10,110,285	12,119,586	14,846,089	17,277,588	10,216,898	15,152,136
Kosto e transmetimit për humbjet		801,106	701,522	664,679	694,984	753,293
<i>Kosto e transmetimit për humbjet e njohur nga ERE për vitin 2015</i>	787,028	787,028			787,028	
<i>Kosto e transmetimit për humbjet mbi target sipas VKM 253</i>		14,078			92,044	
Kosto e humbjeve Totale		11,223,550	14,037,954	16,500,965	14,111,248	14,286,900
<i>Kosto e transmetimit për humbjet e njohur nga ERE për vitin 2015</i>	9,323,257	9,323,257			9,323,257	
<i>Kosto e transmetimit për humbjet mbi target sipas VKM 253</i>		1,900,293			4,787,991	
Disbalanca		94,930	106,613	111,944	106,613	111,944
Total OPEX	17,994,285	20,622,576	25,400,600	28,019,055	19,025,251	24,224,240

Gjatë këti procesi, sikurse cituar më sipër, janë shkëmbyer një sërë korrespondecash në lidhje me konstatimet dhe mangësitë e evidentuara në kuadër të aplikimit të tarifave të shpërndarjes për vitin 2022 si dhe janë zhvilluar seanca dëgjimore teknike dhe publike. Theksojmë se, vlerësimet e shoqërisë për vitin 2022 janë mbështetur sikurse deklarohet në aplikim, vetëm në realizimin e shpenzimeve të vitit 2020, i cili është viti i parë i funksionimit të shoqërisë në mënyrë të pavarur, si dhe parashikimet për vitin 2021 (tashmë i mbyllur). Në zbatim të përcaktimeve të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, “Sistemit të njehsuar dhe të standartizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike”, miratur me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 244, datë 26.11.2018, dhe Metodologjisë e llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike, miratur me Vendimin Nr.182, datë 10.11.2017, të Bordit të ERE-s, është kërkuar vazhdimisht dërgimi në formë analitike i shpenzimeve operative faktike të OSSH-së për vitin 2020 si dhe pasqyrat financiare të plota të vitit 2021, informacione të cilat nuk janë përcjellë nga shoqëria.

Pë sa më sipër, në mungesë të dërgimit të informacioneve të kërkuara, për vlersësimin e shpenzimeve operative administrative, kemi kryer vlerësimet tona mbështetur në realizimin e këtyre shpenzimeve sipas të dhënave të evidentuara në pasqyrat financiare të vitit 2020 si dhe

pasqyrave financiare të OSSHEE sh.a. për periudhën 2015 - 2019 duke alokuar dhe ndarë vlerën totale të shpenzimeve ndaj OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a. mbështetur në koeficientët sipas “Metodologjisë së alokimit të shpenzimeve”, të depozituar në ERE gjatë procesve të mëparshme tarifore.

Nga sa konstatuar në pasqyrat financiare të vitit 2020, shpenzimet operative nuk janë paraqitur sipas kategorive të shpenzimeve të njohura nga ERE dhe nga OSSH sh.a., në proceset e mëparshme tarifore, por sipas zërave të evidentuar në vijim:

Shpenzime Operative	8,502,990
Shpenzime materiale dhe konsumi	695,413
Shpenzime per personelin	4,753,607
Sherbime nga pale te treta	1,138,003
Qera	148,635
Sherbime postare dhe komunikimi	24,069
Te tjera	1,743,263

Për të patur një evidencë të vijimësisë së shpenzimeve operative për secilën periudhë dhe për të vlerësuar mbi parashikimet e tyre për vitet 2021 dhe 2022, ishte e nevojshme shpërndarja e vlerës së shpenzimeve operative të vitit 2020 sipas kategorive të njohura nga ERE dhe të pranuar nga OSSH sh.a. sikurse paraqitur dhe në aplikimet e periudhave të mëparshme.

Për grupet e shpenzimeve është konsideruar vlera e paraqitur në pasqyrat financiare 2020, ndërsa për ato zëra, të cilat nuk janë të identifikueshme sipas pranimeve të ERE, shpërndarja e vlerës së secilit grup shpenzimi është përlllogaritur bazuar në mesataren e realizuar të secilit zë për periudhën 2015-2020, për të cilën ka patur vendimmarje dhe analiza periodike, duke e indeksuar me normën e synuar të inflacionit, sikurse evidentohet në tabelën “Shpenzimet operative dhe kosto e blerjes së energjisë”

Në vijim paraqesim pranimet dhe arsyetimet tona në lidhje me shpenzimet operative për vitin 2021 dhe vitin 2022.

Shpenzimet e personelit

OSSH ka kërkuar t’i njihet realizimi i këtij shpenzimi për vitin 2022 duke indeksuar vlerën e parashikuar prej tyre për vitin 2021, ndërkohë që nuk ka paraqitur asnjë përlllogaritje apo evidencë në lidhje me koston e parashikuar të 2021, detaj i cili është sqaruar edhe më lartë. Gjithashtu, një nga kërkesat është njohja në këtë zë shpenzimi e pagës së 13 (trembëshjetë), e cila në vitin 2020 nuk është paguar për shkak të performancës me rezultat financiar negativ të OSSH. Konstatohet se shpenzimet e parashikuara për këtë zë sipas të dhënave të paraqitura në aplikim, rezultojnë me një rritje prej 6% për vitin 2021 krahasuar me 2020 dhe 3% për vitin 2022 në raport me parashikimin e 2021.

Kostot mesatare të personelit për periudhën 2015 - 2019 kanë rezultuar në vlerën 4.5 miliardë lekë, me një rritje progresive nga viti në vit. Duke indeksuar vlerën mesatare të realizuar të këtij shpenzimi, për periudhën 2015 – 2019, me normën e synuar të inflacionit prej 3% do të rezultonte përafërsisht në vlerën e realizuara të këtij shpenzimi për vitin 2020.

Nisur nga arsyetimet e lartë përmendura mbi Shpenzimet Operative Administrative, Shpenzimet e Personelit, për vitin 2021 janë indeksuar me nivelin e synuar të normës së inflacionit prej 3% mbi realizimin e tyre të vitit 2020. Më tej, është aplikuar e njëjta normë indeksimi dhe për vitin 2022 mbi vlerën rezultuese të vitit 2021.

Shpenzimet e mirëmbajtjes

OSSH sh.a me shkresën Nr.237 Prot, datë 09.02.2022, ka paraqitur në formë analitike shpenzimet e mirëmbajtjes të parashikuara për vitet 2021 dhe 2022.

Tabella: Parashikimi mbi kostot e mirëmbajtjes 2021

Mirëmbajtje	2,676,504
Shpenzime operative (materiale)	1,400,000
Riparime dhe mirëmbajtje e ndërtesave	25,000
Riparime dhe mirëmbajtje e makinave	192,439
Riparime dhe mirëmbajtje - te tjera	9,000
Riparim transformatoresh	300,000
Shpenzime Kolaudimi Matesash	750,064

Tabella: Parashikimi mbi kostot e mirëmbajtjes 2022

Mirëmbajtje	2,756,799
Shpenzime operative (materiale)	1,442,000
Riparime dhe mirëmbajtje e ndërtesave	25,750
Riparime dhe mirëmbajtje e makinave	198,212
Riparime dhe mirëmbajtje - te tjera	9,270
Riparim transformatoresh	309,000
Shpenzime Kolaudimi Matesash	772,566

Nisur nga deklaratimet dhe vlerësimet e OSSH sh.a, plani i parashikuar i Shpenzimeve të Mirëmbajtjes, i miratuar sipas buxhetit për vitin 2021, është në vlerën 2,095 milion lekë. Shpenzime të mirëmbajtjes që nuk rrisin jetëgjatësinë e aseteve janë në vlerën 1.4 miliard Lekë, ndërsa shpenzime të mirëmbajtjes të cilat ripërtërijnë jetën e aseteve janë në vlerën 695 milionë Lekë.

Konstatojme se për vitin 2022, kostot e mirëmbajtjes janë parashikuar në vlerën totale prej 2,756 milionë lekë, ku 1,442 milion janë shpenzime të mirëmbajtjes të cilat nuk rrisin jetëgjatësinë e aseteve, 772 milionë lekë janë parashikuar për kolaudim të aparateve matës të energjisë elektrike dhe diferenca prej 542 milionë lekë nga vlera totale e paraqitur, (kompania deklaron se është vlera e shpenzimeve të cilat rrisin jetëgjatësinë e aseteve.) Lidhur me këtë vlerë, vërejmë se kostot e krijuara pas blerjes së asetit, të tilla si kostot e krijuara me pas për të shtuar, zëvendësuar apo shërbyer asetit, duhet të njihen në koston e aktiveve afatgjata materiale

Shpenzimet për riparime, të cilat rrisin jetën e dobishme të aseteve, duhet të njihen në pjesën e shpenzimeve kapitale sepse pritet që ato të përdoren për një periudhë më të gjatë. Si rrjedhojë, këto shpenzime nuk mund të konsiderohen në përlllogaritjen e shpenzimeve operative, pasi do të rezultonte në një rritje të paarsyetuar të OPEX-eve në kohën që vlerën që merr aseti shoqëria e rekurron nëpërmjet amortizimit

Kostot mesatare të mirëmbajtjes për periudhën 2015 - 2019 kanë rezultuar në vlerën 1.1 miliardë lekë. Vërejmë se këto kosto kanë arritur në rritje nga viti në vit. Realizimi i këtij

shpenzimi, nga sa konstatohet në Pasqyrat Financiare të vitit 2020, ka arritur rreth vlerës 1.4 miliard lekë. Nisur nga fakti se rrjeti është i amortizuar dhe shoqëria ka nevojë të kryejë mirëmbajtje të vazhdueshme për qëllime të sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe cilësisë së shërbimit të ofruar, konsiderojmë se vlera e parashikuar nga OSSH për vitet 2021-2022 , të jetë dhe vlera e pranuar nga ERE për llogaritjen e këtij shpenzimi.

Shpenzime qiraje

Shoqëria deklaron se në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për qiratë e ndërtesave, magazina dhe zyra si dhe shpenzimet e qirave të automjeteve. Vlera e planifikuar e këtyre shpenzimeve për vitin 2022 është bazuar në shpenzimet e vitit 2020 si dhe parashikimin e vitit 2021 duke rezultuar në vlerën 341 milion lekë.

Nga sa konstatohet në Pasqyrat Financiare të vitit 2020, ky shpenzim është realizuar në vlerën 148 milion lekë. Meqënëse ky shpenzim është kërkuar nga shoqëria të njihet me një rritje të konsiderueshme krahasuar me kostot faktike të vitit 2020, në të cilin shoqëria ka operuar për herë të parë si entitet i pavaruar, ERE me anë të shkresave Nr. 925/5 Prot., date 26.11.2021, dhe Nr. 925/8 Prot, datë 15.12.2021, ka kërkuar paraqitjen e shpenzimeve operative në tërësi në formë analitike, shpjegime dhe argumenta lidhur me parashikimet e shoqërisë si dhe informacion justifikues lidhur me vlerën e shpenzimeve të qirasë, të cilat konsiderojnë dhe qiratë financiare që priten të realizohen në vitin 2021 dhe 2022 .

OSSH nuk ka përcjellë asnjë informacion analitik në lidhje me sa kërkuar nga ERE por ka dhënë vetëm deklarime narrative, duke cilësuar se informacioni i kërkuar prej ERE gjendet në dokumentin e pasqyrave financiare të OSSH si dhe në analizën e treguesve kryesorë të realizuar dhe paraqitur në Aplikimin për Tarifa të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Bashkëlidhur këtij deklarami, ka paraqitur dhe tabelat në vijim:

Realizimi i treguesve kryesorë të shoqërisë krahasuar me ata të planifikuar për periudhën Janar-Tetor 2021 gjendet në tabelën më poshtë:

000/Lekë	Pershkrimi	Janar-Teor 2021	Buxheti Janar-Tetor 2021	Diferenca	%
Te ardhurat	Te ardhura nga Shpërndarja	22,632,490	21,484,327	↑ 1,148,163	105%
	Te tjera	89,887	33,669	↑ 56,218	267%
	Gjithsej	22,722,377	21,517,996	↑ 1,204,381	106%
Shpenzimet	Shpenzime Energji e Blere	12,156,719	8,892,814	↓ 3,263,906	137%
	Transmetim dhe disbalanca	832,190	594,850	↓ 237,340	140%
	Shpenzime Operative	9,386,238	8,962,512	↓ 423,726	105%
	Provizione	-	-		
	EBITDA	347,230	3,067,821	↓ (2,720,591)	11%
	Amortizimi	2,565,622	2,104,084	↓ 461,538	122%
	Shpenzime Financiare	27,750	(210,273)	↓ 238,023	-13%
	Tatim Fitimi	-	176,351	↑ (176,351)	0%
Gjithsej	24,968,520	20,520,338	↓ 4,448,181	122%	
REZULTATI I FINANCIAR		(2,246,142)	997,658	↓ (3,243,800)	-225%

Realizimi i pritshëm i treguesve kryesorë të shoqërisë krahasuar me ata të planifikuar për vitin 2021 gjendet në tabelën më poshtë:

000/Lekë	Pershkrimi	Realizimi i pritshëm 2021	Plani Financiar 2021	Diferenca	%
Te ardhurat	Te ardhura nga Shpërndarja	26,744,791	25,781,192	↑ 963,598	104%
	Te tjera	108,481	40,403	↑ 68,078	268%
	Gjithsej	26,853,272	25,821,596	↑ 1,031,676	104%
Shpenzimet	Shpenzime Energji e Blere	14,576,929	10,671,376	↑ 3,905,553	137%
	Transmetim dhe disbalanca	1,204,897	713,820	↑ 491,077	169%
	Shpenzime Operative	12,234,570	10,755,014	↑ 1,479,556	114%
	EBITDA	(1,163,125)	3,681,385	↓ (4,844,510)	-32%
	Amortizimi	3,078,747	2,524,901	↓ 553,846	122%
	Shpenzime Financiare	11,404	9,295	↓ 2,109	123%
	Gjithsej	31,106,548	24,674,406	↑ 6,432,141	126%
REZULTATI I FINANCIAR		(4,253,276)	1,147,189	↓ (5,400,465)	-371%

Këto tabela, si në aplikim ashtu edhe në përgjigjet e shoqërisë, nuk janë shoqëruar me analiza apo shpjegime mbi përmbajtjen e tyre. Theksojmë se vlerat paraqiten në parashikim dhe jo duke u krahasuar me kostot faktik të tyre të cilësuar nga OSSH për vitin 2020.

Nisur nga arsyetimet e sqaruara më sipër mbi Shpenzimet Operative Administrative dhe duke konsideruar faktin se shoqëria nuk ka argumentuar dhe justifikuar rritjen e këtij shpenzimi për vitin 2021 dhe 2022 si dhe mbështetur gjithashtu në parimet e vendosjes së tarifave në zbatim të legjislacionit në fuqi, shpenzimet e qerave për vitin 2021 janë indeksuar me nivelin e synuar të inflacionit prej 3% ndaj vlerës së realizuar në vitin 2020. Më tej, është aplikuar e njëjta normë indeksimi edhe për vitin 2022 kundrejt vlerës rezultuese të vitit 2021.

Vlera e përlogaritur paraqitet në tabelën “Shpenzimet operative dhe kosto e blerjes së energjisë”

Shpenzime të tjera

Lidhur me këtë shpenzim, shoqëria ka përcjellë vetëm deklarime narrative dhe asnjë të dhënë analitike mbi realizimin e tij në 2020, i cili është viti që sipas shoqërisë ka shërbyer për përlllogaritjen e shpenzimeve operative për vitin 2022. OSSH deklaron se në këtë zë për vitin 2022 përshihen disa shpenzime, ku vlerën më të konsiderueshme të tyre e përbëjnë shërbimi i sigurimit të godinave, shpenzimet për projekte të veçanta të shoqërisë që kryhen me ekspertë vendas dhe të huaj si dhe primi i sigurimit për aksidentet dhe fatkeqësitë natyrore.

Konstatohet se realizimi i këtij zëri, për vitin 2020 ka qënë në vlerën 1.7 miliard lekë. Nisur nga informacionet dhe të dhënat e dërguara nga OSSH, shpenzimet e tjera i konsiderojnë dhe shpenzimet korporative të realizuara për vitin 2020 në vlerën 1.1 miliard lekë dhe shpenzime të tjera të realizuara në vlerën 600 milion lekë.

Nga analiza e kryer për periudhën 2015 - 2019, vlera mesatare e realizuar e këtij shpenzimi rezulton 820 milion lekë

Në informacionet dërguara OSSH sh.a. ka paraqitur dhe identifikuar shpenzimet korporative të cilat përfshijnë zërat si vijon:

- ✓ Sherbime Burime njerezore,
- ✓ Sherbime Ekonomike,
- ✓ Sherbime te Zhvillimit te Biznesit
- ✓ Sherbime te Medias,
- ✓ Sherbime Mbeshtetese,
- ✓ Sherbime IT
- ✓ Sherbime Ligjore

Sipas deklarimeve të shoqërisë, këto shpenzime realizohen nëpërmjet “Marrëveshjes se ofrimit të shërbimeve” me OSHEE Group, bazuar në historikun e shoqërisë me objekt uljen e shpenzimeve dhe rritjen e performances së OSSH sh.a.

Në vijim të procesit të shqyrtimit të aplikimit të tarifës, me shkresën Nr. 925/5 Prot, të datës 26.11.2021, ERE i ka kërkuar shoqërisë OSSH sh.a paraqitjen e informacionit në mënyrë analitike mbi shërbimet korporative për 2020 dhe 2021 si dhe parashikimet për vitin 2022. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë parimin e transparencës së kostove të përfshira në tarifë, specifikuar në pikën 11, neni 5, të “Metodologjisë e llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike”, janë kërkuar argumenta dhe sqarime mbi zërat “Shërbime ligjore”, “Marrëdhënie me Publikun” dhe “Teknologji IT”, të cilat janë evidentuar si në shpenzimet korporative ashtu edhe në kategoritë e shpenzimeve operative të shoqërisë.

Sa më sipër, shoqëria ka argumentuar se kontratat e shërbimeve korporative nuk pengojnë OSSH të kryejë shpenzime të drejtëpërdrejta për pajisje dhe shërbime të të njëjtit grup. Sipas OSSH sh.a, këto shërbime kontraktohen nga shoqëria mëmë OSHEE Group sh.a, ne rastin kur njesia përgjegjëse e ofrimit të shërbimit nuk gëzon ekspertizën e mjaftueshme për realizimin e tij.

Në përlogaritjen e çmimit të tyre janë përfshirë shpenzimet financiare të shoqërisë mëmë, të cilat sipas deklarimeve të OSSH sh.a, janë kostot e kredive të marra nga OSHEE Group sh.a, në kohën kur nuk ishin krijuar ende shoqëritë bija. Objekti i këtyre kredive ishte kryerja e investimeve si dhe sigurimi i likuiditetit për blerjen e energjisë në tregun e lirë gjatë periudhave të thatësirës. Po kështu, në përlogaritjen e çmimit të këtyre shërbimeve janë përfshirë edhe provigjonet, të cilat rrjedhin nga shpenzimet përmbartimore të çështjeve ligjore të lidhura me aktivitetin e veprimtarive të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike, aktivitete të cilat nuk janë të lidhura me objektin e veprimtarisë së OSHEE Group sh.a. Duke qenë se këto kontrata janë lidhur para krijimit të shoqërive OSSH sh.a dhe FSHU sh.a., shpenzimet e tyre alokohen përmes shpenzimeve për shërbime korporative.

Shpenzimeve korporative për vitin 2020, të dërguar nga shoqëria, paraqitet si vijon:

(000/Lekë)

Nr.	PËRSHKRIMI	TOTAL	OSSH	FSHU	FTL
1	SHËRBIME TË MEDIAS	58,448	27,768	30,679	-
2	SHËRBIME TË ZHVILLIMIT TË BIZNESIT	80,568	69,348	10,848	372
3	SHËRBIME TË BURIMEVE NJERËZORE	86,528	74,478	11,651	399
4	SHËRBIME LIGJORE	319,573	78,482	236,152	4,938
5	SHËRBIMET MBËSHTETËSE	505,685	502,482	2,177	1,026
6	SHËRBIMET IT	769,278	398,279	365,047	5,952
7	SHËRBIMET EKONOMIKE	158,937	64,419	79,347	15,171
	TOTAL	1,979,017	1,215,256	735,903	27,858

Referuar të dhënave të përcjella nga OSSH, shpenzimet korporative për vitin 2021 janë parashikuar në vlerën 1,259 milion lekë dhe për vitin 2022 në vlerën 1,168 milion lekë sipas tabelës në vijim:

(Lekë)

Nr.	PËRSHKRIMI	TOTAL	OSSH	FSHU	FTL
1	SHËRBIME TË MEDIAS	40,505,855	19,244,198	21,261,658	-
2	SHËRBIME TË ZHVILLIMIT TË BIZNESIT	71,667,637	61,686,866	9,649,979	330,791
3	SHËRBIME TË BURIMEVE NJERËZORE	76,969,474	66,250,345	10,363,867	355,263
4	SHËRBIME LIGJORE	183,565,987	95,081,051	85,648,376	2,836,561
5	SHËRBIMET MBËSHTETËSE	484,269,969	481,942,510	2,133,388	194,071
6	SHËRBIMET IT	549,333,054	383,773,272	162,013,411	3,546,372
7	SHËRBIMET EKONOMIKE	103,096,193	59,969,089	40,390,161	2,736,942
	TOTAL	1,509,408,171	1,167,947,331	331,460,840	10,000,000
	ÇMIMI MUJOR I SHËRBIMEVE	125,784,014	97,328,944	27,621,737	833,333

Në zbatim të përcaktimeve të pikës 1, të neni 21, të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, tarifat e rrjetit, ndër të tjera, duhet të jenë transparente dhe të reflektojnë kostot reale.

Nga shqyrtimi i të dhënave, argumentave dhe deklarimeve lidhur me këtë grup shpenzimi të OSSH sh.a., vlerësojmë se nuk mund të kryhet një analizë, e cila mund të identifikojë realizimin e këtyre shpenzimeve në periudhat e meparshme ushtrimore e më tej identifikimin/parashikimin e këtyre shpenzimeve për vitet 2021 dhe 2022.

Këto shpenzimeve nuk mundësojnë përlllogaritjen e drejtë të masës së shërbimit/kostos operative të realizuar dhe sjellin pasiguri në aplikimin e parimit të mos ndër-subvencionimit të kostove midis aktiviteteve të shoqërive të rregulluara dhe shoqërive, të cilat nuk janë objekt monitorimi apo rregullimi nga ana e ERE-s.

Planifikimi/realizimi i grupeve të shpenzimeve sipas miratimit të tyre në periudhat e mëparshme rregullatore nga ERE duhet të zbatohet nga shoqëria OSSH sh.a., ku baza e planifikimit të shpenzimeve operative duhet të ishte konsistente dhe e mbështetur në parimin e vijimësisë, duke vlerësuar mbi realizimin e këtyre shpenzimeve në kohë, në mënyrë që kostot të transferohen sa më drejtë ndaj çmimeve të klientëve fundorë. Këtë vlerësim ERE e ka adresuar ndaj OSSH nëpërmjet shkresës Nr. 177 Prot, datë 26.01.2022.

OSSH mund të zgjedh të përfitojë nga shërbimet e ofruara nga shoqëria mëmë nëse evidenton se kjo zgjedhje rezulton me kosto më të ulët dhe nuk implikon një varësi të panevojshme. Për këtë arsye, vlerësojmë të domosdoshme kryerjen e analizës së kosto-përfitimit në lidhje me marrjen e këtyre shërbimeve në këtë mënyrë krahasuar me realizimin e shpenzimeve të të njëjtës natyrë në periudhat e mëparshme.

Në vijim të vlerësimit të mësipërm, OSSH sh.a. me anë të shkresës nr. 801/1 Prot, datë 22.02.2022, ka adresuar ndaj ERE kërkesën për dërgimin e propozimeve të detajuara të ERE në përmirësimin e metodologjisë dhe të kontratës së shërbimeve, e cila është tashmë e vlefshme dhe për vitin 2022.

ERE me shkresën Nr.237/8 Prot, datë 18.03.2022 është shprehur se nuk ka asnjë detyrim ligjor të propozojë ndryshime apo llogaritje për një kontratë/metodologji që nuk është objekt i rregullimit të saj, e cila lidhet me marrjen e shpenzimeve apo shërbimeve midis OSSH sh.a. dhe një pale të tretë.

Duke konsideruar të rëndësishëm operimin e OSSH sh.a tashmë si një entitet i pavarur nga pikëpamja ligjore, funksionale dhe financiare, ERE, ka shprehur vlerësimin e saj mbi mënyrën se si duhet të përlllogariten dhe evidentohen kategoritë e shpenzimeve operative, mbështetur në analizat dhe vendimarrjet e periudhave të mëparshme rregullatore, në mënyrë që planifikimi i shpenzimeve operative të jetë konsistent dhe i mbështetur në parimin e vijimësisë,

Ky vlerësim mbështetet në paraqitjen dhe evidentimin e shpenzimeve operative të matshme dhe të argumentuara në periudhat ushtrimore tashmë të mbyllura në mënyrë që kostot e pritshme të OSSH sh.a. të vlersohen sa më drejtë gjatë procesit të shqyrtimit të aplikimit të tarifave, për faktin se këto kosto transferohen te klientët fundorë, në zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”,

Shpenzimet të tjera për periudhën 2015 -2019 janë realizuar mesatarisht në vlerën 820 milion lekë sikurse shprehur më lartë. Trendi i realizimi të këtij shpenzimi ka ardhur në rritje nga viti në vit duke rezultuar në vlerën 1.1 miliard lekë për 2019. Referuar realizimit të zërit “shpenzime të tjera” për 2020, i cili mbështetur në pasqyrat financiare përshin dhe zëra të kategorive të shpenzimeve operative të pranuar nga ERE, sikurse sqaruar edhe më lart (psh “Shërbime ligjore”, “Marrëdhënie me Publikun” ,“Teknologji Informacioni”, etj),

konsiderojmë se vlera më përfaqësuese e këtij shpenzimi për qëllim të përlllogaritjes së OPEX për vitin 2020 të mbështetet në vlerën e rezultuese të zërit “shpenzime të tjera” të vitit 2019 (e përlllogaritur bazuar në Metodologjinë e alokimit të shpenzimeve operative të OSHEE sh.a të depozituar në ERE gjatë proceseve të mëparshme tarifore), të indeksuar me normën e synuar të inflacionit në mungesë të të dhënave të detajuara të këtij grup shpenzimi për vitin 2020. Për vitin 2021 ky shpenzim është përlllogaritur duke indeksuar vlerën rezultuese të 2020 me normën e synuar të inflacionit prej 3% dhe në vijim është aplikuar i njëjti parim edhe për vitin 2022 kundrejt vlerës rezultuese të vitit 2021.

Vlera e përlllogaritur paraqitet në tabelën “Shpenzimet operative dhe kosto e blerjes së energjisë”

Shpenzimet per zerin “Marrëdhënie me publikimin dhe marketing”

Në vlerësimin e këtyre shpenzimeve, sikurse sqaruar dhe më lartë në zërat e tjerë të shpenzimeve operative është njohur vlera e realizuar nga shoqëria në vitin 2020 dhe është indeksuar me normën e synuar të inflacionit prej 3% për parashikimin e viteve 2021 dhe dhe në vijim është aplikuar i njëjti parim edhe për vitin 2022 kundrejt vlerës rezultuese të vitit 2021.

Shpenzimet për materiale konsumi

Nga analiza e kryer për periudhën 2015 - 2019, ky zë është realizuar mesatarisht në vlerën 455 milion lekë. Në lidhje me vitin 2020, ky shpenzim është realizuar në vlerën 695 milion lekë, për arsye të gjendjes së jashtëzakonshme të krijuar prej tërmetit në fundin e vitit 2019. Në vlerësimin e këtij shpenzimi është marrë në konsideratë vlera e kërkuar nga shoqëria OSSH sh.a prej rreth 295 milionë lekë për vitin 2021 dhe 305 milionë lekë për vitin 2022. Ky pranim është bërë meqenëse këto vlera rezultojnë në përputhje me mesataren e realizimeve të këtij shpenzimi për periudhën 2016 – 2018, ku shoqëria ka ushtruar aktivitet normal dhe jo të ndikuar nga rrethana të jashtëzakonshme. OSSH deklaroi se shpenzimet për karburant zënë peshën kryesore në këtë zë të shpenzimeve për vitin 2022, të cilat janë planifikuar bazuar në shpenzimet e pritshme të vitit 2021. Gjithashtu, bazuar në deklaratat e shoqërisë, sasia e shpenzuar në lloje të ndryshme karburantesh për lëvizjen e mjeteve të shoqërisë parashikohet të jetë e njëjtë. Sqarojmë se shpenzimet për materiale konsumi sikurse deklaruar nga OSSH përfshijnë shpenzimet për veshje pune për punonjësit dhe rritjen e standartit të tyre.

Lidhur me pranimet e zërave **Sherbime Postare dhe Komunikimi, Shpenzime Teknologjia e informacionit, Shpenzime Ligjore dhe Konsulence dhe Auditim** pas analizës së periudhës 2015-2020 sipas pasqyrave financiare, vlerat e konsideruara nga OSSH për periudhën 2021-2022 janë dukshëm më të ulta se mesataret e realizuara të këtyre shpenzimeve në periudhën 2015 - 2020. Për këtë arsye, meqenëse shoqëria ka planifikuar ulje të këtyre shpenzimeve në vitin 2022 dhe një pjesë e këtyre shpenzimeve përfshihen në zërin shpenzime të tjera, sikurse shprehur më lartë në këtë relacion, vlerësojmë pranimin e këtyre shpenzimeve si më poshtë:

Shërbime Postare dhe Komunikimi

Në vlerësimin e këtij shpenzimi është marrë në konsiderate vlera e planifikuar nga shoqëria OSSH sh.a për vitet 2021 - 2022 siç evidentohet në tabelën e mësipërme. Këto shpenzime përbëhen kryesisht nga shërbimet për internet dhe telefoni si dhe shpenzime të postës së zakonshme për shoqërinë OSSH.

Shpenzime Teknologjia e informacionit

Në vlerësimin e këtij shpenzimi është marrë në konsideratë vlera e planifikuar nga shoqëria OSSH sh.a për vitet 2021 - 2022, sikurse evidentohet në tabelën e mësipërme.

Shpenzime Ligjore

Në vlerësimin e këtij shpenzimi është marrë në konsiderate vlera e planifikuar nga shoqëria OSSH sh.a për vitet 2021 - 2022, sikurse evidentohet në tabelën e mësipërme.

Konsulencë dhe Auditim

Për këtë shpenzim, shoqëria deklaron se vlera e tyre parashikon të mbulojë detyrimin ligjor për auditim të veprimtarisë së shoqërisë si edhe nevojat për konsulencë vendase dhe të huaj, të cilat në kushtet e menaxhimit të pavarur janë të domosdoshme sidomos gjatë viteve të para të aktivitetit.

Lidhur me sa më sipër, kemi vlerësuar se për vitin 2020, të konsiderohet vlera mesatare e realizuar e këtij zëri në periudhën e mëparshme, prej 80 milione leke. Për vitin 2021 ky shpenzim është përlogaritur duke indeksuar vlerën rezultuese të 2020 me normën e synuar të inflacionit prej 3% dhe në vijim është aplikuar i njëjti parim edhe për vitin 2022 kundrejt vlerës rezultuese të vitit 2021.

Kosto e blerjes së energjisë

Sipas të dhënave të paraqitura së fundmi nga OSSH sh.a., sasia e lëvruar në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2021 ka rezultuar 7,552,369 MWh, ndërkohë që humbjet sipas raportit të konsoliduar të shoqërive FSHU, OSSH dhe FTL të dërguar me anë të shkresës Nr.1425 Prot, datë 10.02.2022, kanë rezultuar në sasinë prej 1,556,953 MWh ose 20.62%.

Niveli i lejuar i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, në zbatim të VKM 253/2019 e ndryshuar, është 20.50% dhe për rrjedhojë sasia e humbjeve e cila duhet të konsiderohet për përlogaritjen e koston së blerjes së humbjeve rezulton si vijon:

$$\underline{7,552,369 \text{ MWh} * 20.5\% = 1,548,235 \text{ MWh}}$$

Shoqëria ka paraqitur Koston e blerjes së humbjeve për vitin 2022, mbështetur në sasinë totale të parashikuar për t'u lëvruar në rrjetin e shpërndarjes, si vijon:

Bilanci energjistik për vitet 2021 – 2022 paraqitet në tabelën më poshtë:

<i>Bilanci energjistik (Mwh)</i>	2021	2022
Energji ne Network	7,492,243	7,581,968
Energji e Blere nga Furnizuesit	7,035,658	6,099,219
Energji e Shitur FSHU	5,500,295	4,612,980
Energji kthyer nga HEC tek OST	376,465	320,000
Energji e Shitur Kliente te tjere	80,120	1,162,750
Humbje Mwh	1,535,362	1,486,239
Humbje %	20.49%	19.60%

Në tabelën e mësipërme nuk është e kuptueshme mënyra e përlllogaritjes së humbjeve në aspektin sasior ndaj sasisë së energjisë për tu lëvruar në rrjetin e shpërndarjes. Ndërkohë, në këtë tabelë, është përfshirë një zë me emërtesën “Energji e kthyer nga HEC tek OST, e cila për vitin 2022 është parashikuar në nivelin 320 GWh. Shoqëria ka dhënë një sërë sqarimesh nëpërmjet korespondencave respektive lidhur me këtë çështje, të cilat janë analizuar dhe diskutuar gjatë procesit të shqyrtimit të këtij aplikimi. OSSH sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 10691/1, datë 14.12.2021 deklaroi se:

Analizat/vleresimet janë kryer në periudha të ndryshme (diference tre vjecare) nga këndvështrimi i penetrimit të Prodhuesit me Përparësi të Energjisë në rrjetin e Shpërndarjes (rrjedhimisht të sasisë së energjisë injektuar në rrjetin e OST), i pari në vitin 2018 dhe i dyti në vitin 2021. Rezultatet e të dy analizave tregojnë një rritje prej rreth 1% të Humbjeve Totale në rrjetin e Shpërndarjes nga ndikimi i rritjes së penetrimit të Prodhuesit me Përparësi të Energjisë në rrjetin e Shpërndarjes.

Më tej, me shkresën Nr.925/8, Prot datë 15.12.2021, ERE ka kërkuar ndaj OSSH shpjegime dhe argumenta mbi sasinë e energjisë elektrike, si energji e injektuar nga HEC-et lokale në rrjetin e transmetimit, si dhe paraqitjen e akt-rakordimet me OST sh.a, ku evidentohet qartë dhe në mënyrë të detajuar sasia e energjisë për vitin 2020 dhe 2021, efektet teknike dhe ekonomike që i shkaktohen OSSH sh.a nga ky fenomen si dhe masat e marra prej tyre për minimizimin e këtyre efekteve gjatë kësaj periudhe dhe periudhës në vijim.

OSSH në vijim të sqarimeve të mësipërme ka deklaruar se : *bazuar në strategjinë e zhvillimeve të investimeve në zonat e BRE për të gjitha nivelet e tensionit, ka studiuar dhe planifikuar kryerjen dhe vazhdimin e investimeve të cilat janë ende në fazën emergjente dhe ka synuar sistemin e kapaciteteve të mëdha prodhuese dhe minimizimin e fenomenëve negative të shfaqura në zonat problematike.*

Më tej nga ana e OSSH u kërkuar organizimi i një seance dëgjimore teknike me qëllim sqarimin dhe detajimin e të gjithë informacionit të dhënë nga shoqëria lidhur me aplikimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes për vitin 2022. Kjo seancë u organizua në ambjentet e ERE me datë 09.03.2022, në zbatim të Urdhërit të Kryetarit Nr.25/2, dat 07.03.2022.

Gjatë kësaj seance, ndër të tjera, u diskutua lidhur edhe me humbjet që shkaktohen nga energjia e injektuar nga HEC-et lokale në rrjetin e transmetimit si dhe në vijim të saj u dërgua një studim mbi ndikimin e rritjes së shkallës së penetrimit të prodhuesve të energjisë së rinovueshme në rrjetin e shpërndarjes, i cili është i publikuar dhe në faqen zyrtare të ERE.

Fenomeni i energjisë së induktuar nga HEC nëpërmjet rrjetit të transmetimit, nuk është konsideruar në sasinë që pritet të shpërndahet ndaj klientëve fundorë dhe njëkohësisht nuk është përfshirë dhe në sasinë totale të energjisë që pritet të lëvrohet në rrjet për vitin 2022.

Sa më sipër, në përlllogaritjen e humbjeve që parashikohen të realizohen sipas targetit të vendosur në VKM Nr. 253/2019, e ndryshuar për vitin 2022, jemi mbështetur në formulën e aplikuar në periudhat e mëparshme nga ERE.

Në tabelat përlllogaritëse të tarifës mesatare të shpërndarjes është parashikuar që për vitin 2022 sasia totale për tu shpërndarë nga OSSH me qëllim furnizimin e klientëve fundorë, do të jetë 5,775,730 MWh. Në zbatim të procedurave të mëparshme të aplikuar nga vetë OSSH sh.a., por dhe vendimarrjeve të ERE në periudhat rregullatore paraardhëse, mënyra e përlllogaritjes së humbjeve paraqitet si vijon:

Sasia e lëvruar në Shpërndarje = Sasia për tu shpërndarë ndaj klientëve fundorë / (1-përqindja e humbjeve)

$$5,775,730 \text{ MWh} / (1-19.6 \%) = 7,183,743 \text{ MWh}$$

Sasia e energjisë së humbur = Sasia e lëvruar ne shpërndarje * Objektivi i humbjeve (%)

$$7,183,743 \text{ MWh} * 19.6\% = 1,408,014 \text{ MWh}$$

Për sa më sipër, kosto e blerjes së humbjeve është përlllogaritur dhe ndarë sipas burimit mbështetur parashikimet e detyrimit të shërbimit publik dhe çmimeve respektive të secilit burim për vitin 2022, si vijon:

Pershkrimi	Njesia	2021	2022 PARASHIKIM
		Shperndarje	Shperndarje
Energji Gjithsej	Kwh	1,548,235	1,408,014
Nga Ashta	Kwh	77,128	231,264
Nga HEC private	Kwh	1,258,123	1,022,113
Nga Burime te Rinovueshme	Kwh	17,824	43,274
Nga Tregu I Lire	Kwh	195,160	111,363
Nga Ashta	Lekë/Kwh	7.75	8.06
Nga HEC private	Lekë/Kwh	7.45	8.57
Nga Burime te Rinovueshme	Lekë/Kwh	12.25	12.25
Nga Tregu I Lire	Lekë/Kwh	20.11	28.18
Nga Ashta	Lekë	597,743	1,863,988
Nga HEC private	Lekë	9,370,504	8,754,602
Nga Burime te Rinovueshme	Lekë	218,343	530,107
Nga Tregu I Lire	Lekë	3,924,658	3,138,203
Kosto Totale	Lekë	14,111,248	14,286,900

Sikurse vërehet, sasia e përlllogaritur e humbjeve për vitin 2022, në zbatim të formulës sipërcituar, rezulton me një diferencë prej 78 GWh nga sasia e parashikuar prej OSSH sh.a.. Kjo sasi, për efekt të përlllogaritjes, është zbritur ndaj sasisë së parashikuar për t'u blerë në tregun e lirë në vitin 2022 meqënëse sasia që pritet të prodhohet prej HEC Ashta, Prodhuesit ekzistues me përparësi dhe prodhuesit e energjisë nga centralet fotovoltaike mbetet e

pandryshuar. Sa i takon cmimit të blerjes së energjisë nga tregu i lirë, është konsideruar çmimi i blerjes së energjisë i aplikuar nga OSSH sh.a. prej 28.18 lekë/kWh

Kosto e transmetimit të humbjeve

Sa i takon kostos së transmetimit të humbjeve, është konsideruar sasia e përlogaritur nga OSSH sh.a. duke aplikuar tarifën rezultuese me të dhënat e vlerësuara deri më tani për OST sh.a. prej 0.85 lekë/kWh për të cilën jemi shprehur në relacionin për shqyrtimin e aplikimit të tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2022 - 2024. Përlogaritjet evidentohen si vijon:

Pershkrimi	Njesia	2021	2022 PARASHIKIM
		Shpe rndarje	Shpe rndarje
Sasi e marrë nga rrjeti i transmetimit	MWh	926,645	886,227
Tarifa e transmetimit	Lekë/Kwh	0.75	0.85
Shpenzime transmetimi	Lekë	694,984	753,293

Kosto e Disbalancave

Sa i takon kostos së disbalancave për periudhën 2021-2022 kemi konsideruar vlerën e paraqitur nga OSSH sh.a. në aplikim për arsye se është e përafërt me vlerën e realizuar në vitin 2020 sipas Pasqyrave financiare.

Shpenzimet Kapitale (CAPEX)

Baza e Rregulluar e Aseteve

Përlogaritja e Aseteve Bazë të Rregulluara e paraqitur prej OSSH sh.a. evidentohet në tabelën si më poshtë vijon (në 000/Lekë)

Zëri	2021	2022
Vlera e investimeve ne v. 2020	69,425,932	69,425,932
Vlera e investimeve qe priten ne v. 2021	7,146,537	14,293,073
Vlera e investimeve qe priten ne v. 2022		5,299,074
minus:Amortizimi i akumuluar	(25,446,937)	(29,818,289)
vlera e RAB pa perfshire kapitalin e punes	51,125,532	59,199,790
Kapitali i punes	2,073,157	2,384,007
Asetet Baze të Rregulluara (RAB)	53,198,688	61,583,797

Nga sa konstatohet në aplikim, Shoqëria nuk ka paraqitur informacion sqarues dhe argumentues lidhur me RAB. Për sa më sipër, ERE i kërkoi OSSH-së informacion lidhur me bazën e rregulluar të asetëve, amortizimin total të akumuluar, shtesat e asetëve të kapitalizuara në formë analitike dhe llogaritjet e amortizimit të akumuluar për periudhën 2015-2021 si dhe parashikimin për vitin 2022. Gjithashtu, u kërkuan argumenta mbi jetën operuese të asetëve apo një analizë të vlerës së amortizimit të akumuluar të llogaritur për të gjitha asetet që përfshihen në bazën e rregulluar të asetëve përgjatë vitit të fundit të periudhës koherente apo

vlerësimin e saj për periudhën e ardhshme rregullatore, të dhëna këto të domosdoshme për përcaktimin e vlerës së Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB-it.)

Shoqëria ka deklaruar se Baza e Rregulluar e Aseteve në OSSH u krijua rishtazi nga ndarja e asetëve të OSHEE Grup gjatë vitit 2020 mbështetur në dokumentin e audituesve ligjor mbi vlerësimin e ndarjes nëpërmjet transferimit të aktiviteteve të shoqërisë. Gjithashtu, lidhur me vlerën e asetëve dhe amortizimit të akumuluar, shoqëria është shprehur se përcaktimi i jetegjatisë së asetëve bëhet në zbatim të përcaktimeve institucioneve fiskale duke përcjellë dhe tabelën si vijon:

Llogaria e vlerës fillestare	Emertimi i llogarisë	Vlera fillestare date 31.12.2019	Amortizimi i akumuluar 31.12.2019	Vlera e mbetur 31.12.2019	Shtesa 2020	Amortizimi i vitit 2020	Vlera fillestare 31.12.2020	Amortizimi i akumuluar 31.12.2020	Vlera e mbetur 31.12.2020
208000	Te tjera AAGJ - JM	58,679	(52,641)	6,038	-	(1,218)	58,679	(53,859)	4,820
208100	Softëare	497,730	(218,758)	278,972	49,920	(83,141)	547,650	(301,900)	245,750
211000	Toka	1,064,968	-	1,064,968	-	-	1,064,968	-	1,064,968
211100	Permiresimi i Tokave	369,108	(105,067)	264,041	-	(26,267)	369,108	(131,333)	237,775
212000	Ndertesa dhe Konstruksione	4,236,353	(486,519)	3,749,834	109,655	(153,387)	4,346,008	(639,906)	3,706,102
213000	Makineri dhe Pajisje	46,773,142	(16,060,794)	30,712,347	1,363,892	(2,731,375)	48,137,033	(18,792,169)	29,344,864
215000	Mjete Transporti	367,846	(254,427)	113,419	13,608	(33,480)	381,454	(287,908)	93,546
218100	Pajisje Zyre	162,101	(93,608)	68,493	13,024	(17,475)	175,125	(111,083)	64,042
218200	Pajisje IT	1,323,874	(977,754)	346,120	190,448	(203,599)	1,514,322	(1,181,353)	332,969
232100	AAGJ - JM ne Proces	51,932	-	51,932	109,566	-	161,498	-	161,498
232200	AAGJ - M ne Proces	10,416,387	-	10,416,387	2,253,699	-	12,670,086	-	12,670,086
	Totali	65,322,120	(18,249,568)	47,072,552	4,103,812	(3,249,942)	69,425,932	(21,499,511)	47,926,421

Në raportin mbi ndarjen e shoqërisë OSHEE sh.a., konstatohet se audituesi ligjor ka shprehur opinion me rezervë për një sërë treguesish financiar. Shoqëria nuk ka kryer verifikimin e inventarit fizik të aktiveve afatgjata materiale me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 dhe nuk ka arritur të marrë titujt e pronësisë për pronat e paluajtshme që ka në përdorim. Për ndarjen e aktiveve materiale dhe jo materiale, kërkesat e arkëtueshme dhe inventarë sipas raportit, drejtuar Asemblesë së Përgjithshme të shoqërisë, janë ndarë në përputhje me aktivitetin e secilës shoqëri të re. Sipas këtij raporti, referencë për përlllogaritjen e vlerës së asetëve, janë marrë të dhënat nga pasqyra financiare të vitit 2019, prej të cilave rezulton se vlera e aktiveve materiale dhe jo materiale neto ka qënë rreth 48,818 milion lekë.

Më tej shoqëria ka përcjellë një pasqyrë të gjendjes së vlerës së asetëve të OSSH sipas grupeve në datën 31.12.2020 e cila paraqitet si më poshtë:

Llogaria e leres fillestare	Emertimi	Vlera fillestare 000/leke ne 31.12.2020
208000	Te tjera AAGJ - JM	58,679
208100	Software	547,650
211000	Toka	1,064,968
211100	Permiresimi i Tokave	369,108
212000	Ndertesa dhe Konstruksione	4,346,008
213000	Makineri dhe Pajisje	48,137,033
215000	Mjete transporti	381,454
218100	Pajisje Zyre	175,125
218200	Pajisje IT	1,514,322
232100	AGJ - JM ne Proces	161,498
232200	AAGJ - M ne Proces	12,670,086
	Totali	69,425,931

Shoqeria nuk ka përcjellë argumenta dhe sqarime për mënyrën e ndarjes së këtyre asetëve në nivel tensioni por dërguar një tabelë duke evidentuar asetet dhe vlerën e amortizimit të akumuluar si më poshtë:

	Vlera historike e asetëve	Amortizimi	Vlera neto
TL	4,027,763,503	-773,953,973	3,455,747,180
35kv	3,457,530,877	-1009492209	2,448,038,668
20/10/6kv	31,136,927,320	-8194174671	22,942,752,649
0.4kv	30,803,710,154	-11521889742	19,281,820,412
TOTAL	69,425,931,854	-21,499,510,595	48,128,358,909

Në vijim ERE me anë të shkresës Nr. 925/8 Prot, datë 15.12.2021 kërkoi ndaj OSSH argumenta dhe sqarime mbi kriteret e përdorura për përcaktimin e jetës operuese të asetëve, të cilat i përkasin aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe paraqitjen e listës së bazës së rregulluar të asetëve me kostot historike për çdo vit të periudhës 2015 - 2021 (pa marrë në konsideratë rivlerësimin e tyre), duke evidentuar dhe normat përkatëse të amortizimit për çdo kategori aseti si dhe për çdo vit të periudhës së sipërcituar.

Në vijim të kësaj kërkesë, OSSH ka risjellë të njëjtin argumentim mbi bazën e rregulluar të asetëve dhe amortizimin e tyre, duke mos dërguar informacione plotësuese dhe sqaruese për sa kërkuar nga ERE.

ERE, me anë të shkresës Nr. 177 Prot, datë 26.01.2022, argumentoi se asetet e cilësuar prej OSSH në vlerën neto të akumuluar, mbështetur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të audituara për vitin 2020, depozituar me shkresën Nr.8700 Prot, datë 30.09.2021, janë konsideruar edhe investimet në proces, të cilat kanë vlerën 10,416 milion lekë. Nisur nga ky konstatim dhe mbështetur në përcaktimet e metodologjisë në fuqi, u kërkua ndaj OSSH paraqitja e vlerës së njohur të asetëve të përdorura dhe të dobishme, e ndarë për nivele tensioni duke cilësuar dhe normat përkatëse të amortizimit të aplikuarara nga ana e operatorit.

OSSH me anë të shkresës Nr. 801 Prot, datë 22.02.2022 deklaroi se e gjithë vlera e asetëve në proces është në operim dhe moskapitalizimi i këtyre asetëve lidhet me mungesa burokratike të plotësimit të dokumentacionit.

Në përgjigje të kërkesës së ERE-s për plotësim dokumentacioni, OSSH deklaroi se lista e asetëve të trashëguara nga ndarja e shoqërisë OSHEE GROUP sha, mbështetet në aktin e konsulentëve ligjorë për ndarjen e shoqërisë, dokument i cili është dërguar në ERE. Gjithashtu bazuar në "Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike", neni 8/2, OSSH mbetet në pritje të aprovimit të listës së Asetëve të Rregulluara nga ana e ERE-s për vitin bazë, të dërguara me anë të korespondencave të deritanisme.

ERE lidhur me Bazën e Rregulluar të Asetëve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes është shprehur me anë të vendimit Nr. 190/2018., ku sqaron se Vlera e RAB –it e llogaritur nga ERE ka rezultuar më e ulët për arsye se mbështetet në koston historike të asetëve. Kjo çështje është trajtuar dhe më herët në analizën për të ardhurat e kërkuara të rishikuara për vitin 2015.

Duke marrë në konsideratë se për përllogaritjen e vlerës së aseteve sipas raportit të ndarjes së shoqërisë OSHEE sh.a. të përcjellë në ERE, janë vlerësuar të dhenat nga pasqyra financiare e vitit 2019. Në shënimeve shpjeguese të Pasqyrave financiare të vitit 2019, konstatohet se aktivet afatgjata materiale janë rivlerësuar në vitin 2016. Ky rivlerësim ka dhënë një impakt domethënës në rritje të bazës së rregulluar të aseteve të trashëguara nga ndarja dhe si rrjedhojë dhe fitimit të kërkuar prej OSSH sh.a për vitin 2022.

Referuar seksionit 5 të shënimeve shpjeguese të pasqyrave financiare të 2016, Aktivet Afatgjata Materiale, sqarohet se në vitin 2016 shoqëria ka kryer jo vetëm rivlerësime të vlerës së aseteve, por dhe eliminim të amortizimit të akumuluar për rivlerësim si vijon:

Rritje në vlerësim 1,513,463 mijë lekë

Eliminim i amortizimit të akumuluar për rivlerësim 12,660,220 mijë lekë.

Si rrjedhojë e rritjes së vlerës së aseteve për shkak të rivlerësimit por dhe uljes së amortizimit të akumuluar, krijohet efekti i rritjes së vlerës së aseteve të shoqërisë, për të cilat nëse aplikohet dhe kosto mesatare e ponderuar e kapitalit, rezulton në një rritje të fitimit të kërkuar sikurse paraqitet edhe në aplikim.

Për këtë arsye, rivlerësimi i aseteve nuk mund të konsiderohet pasi do t'i krijonte OSSH një fitim të pambështetur në parimet rregullatore të vlerës së drejtë dhe të arsyeshme të kostove të aktivitetit. Marrja e një fitimi mbi asetet e rivlerësuar dhe jo sipas koston historike të tyre, do të rezultonte në një rritje jo të drejtë të kostove të aktivitetit të OSSH, të cilat transferohen ndaj klientëve fundorë.

Shoqëria, përveç kësaj, ka përfshirë në bazën e rregulluar të aseteve dhe investimet në proces, për të cilat normalisht nuk aplikohet amortizim për arsye se nuk janë vënë ende në punë dhe nuk kanë hyrë në operim (parimi use and useful). Për rrjedhojë, duke krijuar një shtesë në llogaritjen e bazës së aseteve, krijohet efekti i rritjes së fitimit të kërkuar, sikurse është shpjeguar edhe më lartë.

Shoqëria OSSH sh.a ka paraqitur vetëm një listë të aseteve në formatin excel, e cila konstatohet se ka mospërputhje me vlerën e shtesave të hyra në operim si dhe me vlerën e aseteve në proces, krahasuar me pasqyrën e aktiveve materiale afatgjata të shënimeve shpjeguese të pasqyrave financiare të audituara për vitin 2020.

Përgjatë këtij procesi, ERE ka kërkuar dërgimin e llogarive të shoqërisë sipas formatit të llogarive të miratuara me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 244/2018, nëpërmjet të cilit është miratuar edhe manuali i llogarive për qëllime të rregullimit të shoqërive të licencuara në sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

Manuali i lartpërmendur, në seksionin “D”, përcakton mënyrë e vlerësimit të aktiveve për qëllime të vendosjes së tarifave dhe çmimeve, mbështetur në parimet thelbësore të përcaktimit të bazës së rregulluar të aseteve.

Në përgjigje të kërkesës së ERE, shoqëria OSSH ka përcjellë një listë emërore të aseteve LISTA E LLOGARIVE SIPAS BILANCIT VERIFIKUES NE DATEN 31.12.2020, të

pashoqëruara me vlera dhe ndarje të kategorive të llogarive, të cilat nuk mundësojnë njohjen e Bazës së Rregulluar të Aseteve.

Parimi i mbajtjes së kostos historike duhet të vijojë të aplikohet për qëllime të vlersimive rregullatore sikurse shprehur jo vetëm në vendimmarrjet e periudhave të mëparshme të ERE-s, por dhe në parimet e seksionit D të “Manualit të llogarive për qëllime të rregullimit të shoqërive të licencuara në sektorin e energjisë elektrike”. Për këtë arsye, deri në momentin që shoqëria do të vijojë të mos paraqesë koston historike të asetëve sipas këtij parimi për ta krahasuar atë me vlerat e pranuar nga ERE në vendimmarrjet e mëparshme, apo të përcjellë në ERE informacion dhe të dhënat të argumentuara apo një studim mbi vlerën e aktuale të asetëve dhe amortizimit të akumuluar të tyre, baza e rregulluar e asetëve dhe vlera e amortizimit të akumuluar për vitin 2015, e miratuar nga ERE, mund të vijojë të njihet për efekt të përlllogaritjes së RAB. Më tej, për çdo vit të periudhës 2015 – 2021, të njihen asetet e hyra në operim sipas pasqyrave financiare duke njohur vlerën e amortizimit të aplikuar për secilën periudhë respektive, me qëllim rikuperimin e asetit të investuar sipas vlerës së shpenzuar duke konsideruar një fitim të arsyeshëm për kthimin e lejuar mbi bazën e rregulluar të asetëve.

Investimet

OSSH sh.a. me shkresën nr. 9505 prot., date 25.10.2021, ka parqitur në ERE kërkesën për shqyrtimin e Planit të Investimeve për vitin 2021 si dhe për përditësimin e Planit të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën 5 - vjecare 2018-2022.

Ndërkohë, Këshilli i Ministrave me Vendim nr. 584, date 8.10.2021, shpalli gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike, ku në pikën 3 të VKM-së përcaktoi se:

"Shoqëritë KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE Group sh.a., të pezullojnë planet e investimeve, përveç investimeve të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë. Keto shoqëri të koordinojnë ushtrimin e aktivitetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim garantimin e pandërprerë të energjisë elektrike".

Për sa më sipër, ERE me anë të shkresës Nr.1037/1 Prot, datë 16.11.2021, kërkoi nga OSSH të përditësimin e Planit të investimeve për vitin 2021 dhe atij të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën 5 - vjecare në kuadër të përcaktimeve të pikës 3 të VKM nr. 584, date 8.10.2021

Deri më tani, OSSH nuk i është përgjigjur kërkesës së ERE-s.

Në vijim, ERE me anë të shkresës Nr.925/5 Prot, datë 16.11.2021, kërkoi ndaj OSSH paraqitjen e investimeve të realizuara dhe të hyra në operim, të ndara për çdo nivel tensioni dhe sipas grupeve të asetëve, për çdo vit të periudhës 2015 - 2020, periudhën Janar - Tetor 2021 dhe parashikimet për periudhën Nëntor - Dhjetor 2021.

Me anë të shkresës Nr. 10691/1 Prot, datë 14.12.2021, OSSH ka përcjellë një informacion narrativ mbi investimet për vlerat e realizuara gjatë vitit 2021, pritshmëritë deri në Nëntor - Dhjetor 2021 dhe investimet në proces që pritet të hyjnë në operim me përfundimin e tyre në gjashtë mujorin e parë të vitit 2022, duke i evidentuar sipas tabelës në vijim:

Investimet e realizuara dhe te futura ne operim gjate 2021	Investime 2020 – 2021 te hyra ne operim brenda Janar – Tetor 2021	Pritshmerite Nentor -Dhjetor 2021	Investime nga 2021 qe priten te mbyllen dhe hyjne ne operim ne 2022	Total
	ALL	ALL	ALL	ALL
Ndertim rikonstruksion N/Stacioni (110/35/20/10kV)	1,047,568,476		1,147,939,747	2,195,508,223
ndertim rikonstruksion linje TL (35kV)	189,579,115		377,949,000	567,528,115
Ndertim Rrjeti TM (20 kV)	509,616,798	144,415,497	311,010,025	965,042,320
Ndertim rrjeti TM/TU (20/0.4kV)	5,579,401,779	1,554,710,260	3,195,443,018	10,329,555,056
Ndertim rikonstruksion kabinash (20/10/6/ 0.4 kV)	69,820,302	50,271,407	-	120,091,709
Investime ne ABC (0.4kV)	3,274,052		163,337,595	166,611,647
Teknologji	921,940,953	-	-	921,940,953
Investim ne matje	198,010,000	-	-	198,010,000
Kosto Lokale BB (punetori	-	-	-	-
Zyra			255,967,248	255,967,248
TOTAL INVESTIME	8,519,211,475	1,749,397,164	5,451,646,633	15,720,255,271

Theksojmë se plani i investimeve për vitin 2022 nuk është përcjellë ende për shqyrtim në ERE. Në zbatim të nenit 75, pika 4 të ligjit 43/2015, i ndryshuar, dhe rregullores së paraqitjes së planit të investimeve, procesi i shqyrtimit të planit të investimeve dhe i aplikimit të tarifave, janë dy procese të lidhura me njëra tjetrën.

Në zbatim të nenit 8, pika 3, të Metodologjisë, në bazën e rregulluar të aseteve do të përfshihet vlera e investimeve të miratuara nga ERE, në përputhje me “Rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve”.

Për aq kohë sa OSSH sh.a. nuk ka paraqitur planin e investimeve për vitin 2022, në zbatim të parashikimeve legjislativitetit të sipërcituar, me qëllim ushtrimin e aktivitetit të shpërndarjes në kushte normale, vlerësojmë të arsyeshme se vlera e investimeve, të cilat mund të pranohen në bazën e rregulluar të aseteve për vitin 2022, të jetë vetëm vlera e investimeve të pranuar dhe miratuar nga ERE në planin 5 vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën 2018-2022 si dokumenti i vetëm në fuqi lidhur me planifikimin e investimeve për këtë periudhë. Vlera e investimeve të parashikura në planin 5 - vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes 2018 – 2022, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 182, datë 20.08.2018, për vitin 2021 është në vlerën 7,471 milion lekë dhe për vitin 2022 është në vlerën 4,706 milion lekë.

ERE në zbatim të Metodologjisë do të aplikojë korigjimet përkatëse bazuar në realizimin e tyre gjatë periudhës në fjalë si dhe duke njohur vlerën e investimeve reale ndaj atyre të planifikuara/miratuara.

Sa më sipër, paraqesim në vijim pranimet e ERE mbi bazën e rregulluar të aseteve të OSSH sh.a. për vitin 2022 krahasuar me vlerat e parashikuara nga shoqëria në aplikim:

Zëri	Miratur nga ERE 2015	2020 FAKT	OSHEE 2021 PARASHIKIM-1	OSHEE 2022 PARASHIKIM	ERE 2021	ERE 2022
Vlera E ASETEVE GJITHSEJ v. 2014	32,042,380	32,042,520			32,042,520	32,042,520
Vlera e investimeve ne v. 2015	2,750,000	1,438,460			1,438,460	1,438,460
Vlera e investimeve ne v. 2016		6,995,748			6,995,748	6,995,748
Vlera e investimeve ne v. 2017		8,497,532			8,497,532	8,497,532
Vlera e investimeve ne v. 2018		6,761,186			6,761,186	6,761,186
Vlera e investimeve e miratuar per v. 2019		5,322,648			5,322,648	5,322,648
Vlera e aseteteve ne v. 2020		1,690,628	69,425,932	69,425,932	1,690,628	1,690,628
Vlera e investimeve qe priten ne v. 2021			7,146,537	14,293,074	3,735,690	7,471,381
Vlera e investimeve qe priten ne v. 2022				5,299,074		2,353,484
Vlera e aseteteve Gjithsej	34,792,380	62,748,722	76,572,469	89,018,080	66,484,412	72,573,587
minus: Amortizimi i akumuluar	- 22,417,000	- 33,950,087	- 25,446,937	- 29,818,289	- 37,240,635	- 41,188,061
vlera e RAB pa përfshirë kapitalin e punës	12,375,380	28,798,635	51,125,532	59,199,791	29,243,777	31,385,526
Kapitali i punës	1,499,524	1,718,548	2,116,717	2,568,255.00	1,585,438	2,018,687
RAB	13,874,904	30,517,183	53,242,249	61,768,046	30,829,215	33,404,212

Amortizimi

Vlera e amortizimit e kërkuar nga shoqëria në aplikimin për tarifën për vitin 2021 është 3,947,426 mijë lekë dhe për vitin 2022 është 4,371,352 mijë lekë, ku vlera e amortizimit për vitin 2022 konsideron dhe amortizimin e shtesave të reja.

Vlerësojmë se vlera e parashikuar prej shoqërisë për amortizimin e asetëve për periudhën 2021-2022 duhet të pranohet për efekt të përlllogaritjes së RAB me qëllim që shoqëria të ketë gjendje likuiditeti për mbulimin e kredive dhe kryerjen e investimeve, të cilat mund të jenë të ndryshme nga vlerat e konsideruara sipas planit 5- vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Mbështetur në parashikimet e “Metodologjisë së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes”, në rastin e realizimit të diferencave mbi/nën vlerat e konsideruara, amortizimi do të korigjohet në periudhën pasardhëse sikurse parashikuar dhe për vlerën e asetëve, të cilat do të hyjnë në operim për periudhën 2021 – 2022, mbështetur në të dhënat e pasqyrave financiare dhe evidencave të justifikuar.

Kapitali i punës

Përsa i përket kapitalit të punës, shoqëria nuk ka paraqitur një studim të fondeve që kërkohen për të mbajtur një nivel të përshtatshëm të materialeve, furnizimeve dhe parave të nevojshme rezervë, për të përmbushur detyrimet korrente dhe për të mbajtur llogaritë minimale. Në mungesë të paraqitjes së studimit të kapitalit të punës, vlera e lejuar e tij është njohur sa 1/12 e Shpenzimeve Operative sipas vlerave të paraqitura në tabelën e mësipërme mbështetur në OPEX-in total.

Përlllogaritjen e normës së interesit të borxhit

Shoqëria OSSH sh.a deklaron se norma e interesit të borxhit për vitin 2022 është përlllogaritur prej normës së interesit të kredive sipas tabelës në vijim:

N r	Emertimi i Kredisë	Norma e interesit	Mone dha	Kursi kemb 31.12.20	Vlera në Lekë	Interesi Lekë					
1	PTDP JBIC ABA	2.30%	JPY	0.9788	1,377,642,119	28,350,425					
2	EDCF - ALBKO Babica Project	3.00%	KRW	0.0927	267,962,356	7,093,121					
3	Fieri Distribution project	0.30%	USD	100.84	219,593,284	539,002					
4	PTDP - IDA (1) Credit 2826 Alb	3.13%	XDR	145.24	648,496,083	20,327,110					
5	Power Loss reduction 2677(Gov.Al)	3.13%	USD	100.84	194,334,707	6,091,421					
6	PSRP Part 2 Credit No 23380	4.06%	EUR	123.70	659,290,236	26,758,942					
7	Distribution project (8,6mldLIT)	2.00%	EUR	123.70	80,271,787	1,605,436					
8	Emergency intervention AID98	1.00%	EUR	123.70	91,496,944	813,306					
9	Commodity Aid VII Power Supply of Korca	0.75%	EUR	123.70	186,630,026	1,244,200					
10	Power Supply of Southern Albania	0.75%	EUR	123.70	296,347,803	1,975,652					
11	Extension of Power Supply of Southern Albania	0.75%	EUR	123.70	145,348,212	1,090,112					
12	Bushat substation (BEI 21264)	4.77%	EUR	123.70	262,283,133	10,915,895					
Shuma pagesava për Huate nga KESH sha					4,429,696,690	106,804,622					
13	Hua AfGjatë MoF (IBRD)	0.75%	Lek		5,120,775,335	37,196,032					
14	Hua AfGjatë MoF (Financim buxhetore)	0.25%	Lek		1,500,000,000	3,750,000					
Shuma e Huave nga MoF					6,620,775,335	40,946,032					
Overdraft nga Bankat (BKT,RZB e CDR)		5.00%			1,081,260,733	27,031,518					
Detyrimi Total					12,131,732,759	67,977,550					
<table border="1"> <tr> <td>Norma e interesit të borxhit të vjetër</td> <td>2.41%</td> </tr> <tr> <td>Norma e interesit të borxhit të ri</td> <td>0.88%</td> </tr> <tr> <td>Norma mesatare e borxhit</td> <td>1.44%</td> </tr> </table>						Norma e interesit të borxhit të vjetër	2.41%	Norma e interesit të borxhit të ri	0.88%	Norma mesatare e borxhit	1.44%
Norma e interesit të borxhit të vjetër	2.41%										
Norma e interesit të borxhit të ri	0.88%										
Norma mesatare e borxhit	1.44%										
<table border="1"> <tr> <td>Borxhi i vjetër</td> <td>33.05%</td> </tr> <tr> <td>Borxhi i ri</td> <td>26.95%</td> </tr> </table>						Borxhi i vjetër	33.05%	Borxhi i ri	26.95%		
Borxhi i vjetër	33.05%										
Borxhi i ri	26.95%										

Për të vlersuar sa më drejtë lidhur me koston e borxhit si dhe destinacionin e përdorimit të fondeve, ERE me anë të shkresës Nr.925/5 Prot. Datë 26.11.2021, kërkoi ndaj OSSH informacion të detajuar dhe të shoqëruar me dokumentacion mbi kreditë e marra nga OSSH sh.a dhe ato të parashikuara gjatë vitit 2022.

OSSH me anë të shkresës Nr. 10691/1 Prot, datë 14.12.2021, përcolli të dhëna të reja mbi huatë afatgjata , duke bërë me dije se është në pritje të miratimit të një kredie në Parlamentin e Shqipërisë në vlerën 15 milin EURO nëpërmjet Bankës Europiane të Rindërtimit dhe Zhvillimit (BERZH për t'u bërë efektive gjatë vitit 2022 me objekt ndërtimin e Nënstacionit të qendrës së Tiranës.

Në lidhje me kreditë afatgjata shoqëria ka përcjellë të dhëna sipas tabelës në viim:

Huatë e përfituara nga OSSH sh.a	Afati I Kredisë (në vite, p.sh. 10 vjet)	Viti I fundit kur përfundon shlyerja e kredisë (p.sh. viti 2031)	Gjendja e principalit të pashlyer të kredisë afatgjatë në fillim të vitit bazë (më 1.1.2021)	Pagesat e interesit të borxhit afatgjatë gjatë vitit bazë 2022	Gjendja e principalit të pashlyer të kredisë afatgjatë në fillim të vitit të 2-të (më 31.12.2022)
PTDP JBIC ABA	19	2026	2,001,904,261	15,170,595	1,724,141,647
EDCF - ALBKO Babica Project	27	2034	649,620,162	12,615,611	583,645,548
Fieri Distribution project	33	2040	1,010,837,040	2,376,264	926,344,582
PTDP - IDA (1) Credit 2826 Alb	10	2017	670,776,415	-	670,776,415
Power Loss reduction 2677(Gov.AL)	10	2017	209,366,547	-	209,366,547
PSRP Part 2 Credit No 23380	7	2014	649,003,816	-	649,003,816
Italian Cooperation (ITC5) (13.02.2003)	34	2041	903,795,273	3,562,837	903,795,273
Distribution project (8,6mldLIT)	8	2015	79,019,366	-	79,019,366
Emergency intervention AID98	23	2030	170,131,062	878,704	150,041,676
March 2000	33	2040	1,070,502,707	2,686,147	1,070,502,707
Commodity Aid VII Power Supply of Korca	33	2040	540,947,726	2,804,055	499,970,619
Power Supply of Southern Albania	37	2044	988,620,579	5,428,539	923,553,430
Extension of Power Supply of Southern Albania	9	2016	143,080,451	-	143,080,451
Bushat substation (BEI 21264)	15	2025	373,614,967	6,693,868	305,943,655
MFE Hua Afat Gjate nga IBRD (Nen Hua MF)	21	2036	4,530,240,276	32,277,962	4497367579
MFE Hua Afat Gjate buxhetore- nga MFE	1	2022	1,500,000,000	3,812,500	
Totali			15,491,460,648	88,307,082	13,336,553,311

Konstatohet se në tabelë janë paraqitur dhe kredi për të cilat viti i shlyerjes së tyre ka përfunduar. Bëhet e paqartë përfshirja e tyre në përllogaritjen e kostos së borxhit dhe nuk jepen sqarime shtesë lidhur me sa evidentuar.

Në vijim, ERE me anë të shkresës Nr.925/8 Prot, datë 15.12.2021, i kërkoi OSSH-së paraqitjen në mënyrë të detajuar të përllogaritjeve mbi koston e borxhit për vitin 2021 si dhe 2022, të shoqëruara me evidenca krahasuese të normave të interesit për borxhin afatgjatë të shoqërisë ndaj normave tregtare të interesit për borxhin, të pranuar nga kompanitë e tjera me risk të ngjashëm krediti. Gjithashtu, shoqëria duhet të paraqiste argumenta mbi qëllimin e marrjes së kredive afatshkurtra dhe shpjegime përkatëse nëse këto hua janë konsideruar në llogaritjen e koston së borxhit.

OSSH me anë të shkresës Nr.11226/2 Prot, datë 04.02.2022, ndër të tjera ka deklaruar performanca negative e vitit 2020 e shoqërisë, me një humbje prej 2.280 miliard Lekë, vendosi shoqërine në vështirësi të madhe likuiditeti dhe se kredia afatshkurtrë prej **540,360 mijë Lekë është përdorur për shlyerjen e detyrimeve për blerje energjie të shoqërisë gjatë vitit 2020.**

Shoqëria në aplikim ka vijuar të ruajë Raportin e borxhit dhe kapitalit sipas përqindjeve të përcaktuara nga ERE në periudhat e mëparshme duke aplikuar 60% borxh dhe 40% kapital.

Konstatohet se shoqëria në përllogaritjet e saj, **ka përfshirë dhe overdraftin, i cili është një linje kreditore afatshkurter me qarkullim 1 vit kalendarik dhe me normë interesi fikse,** që në zbatim të përcaktimeve të Metodologjisë së tarifave nuk mund të jetë pjesë e llogaritjes së borxhit afatgjatë të shoqërisë.

Në metodologji, përcaktohet se për llogaritjen e koston së borxhit në modelin e llogaritjes së WACC do të bazohet në normat e interesit për borxhin e pa paguar të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Normat e interesit të përdorura për përcaktimin e kërkesës për të ardhura mund të jenë ose të mos jenë të njëjta me normat aktuale të interesit të borxhit. Operatori i sistemit të

shpërndarjes duhet të tregojë që normat e interesit për borxhin janë në përputhje me normat tregtare të interesit për borxhin të pranuar nga kompanitë e tjera me risk të ngjashëm krediti. Çdo borxh, i përfshirë në llogaritjen e normës mesatare të interesit të borxhit, që ka një normë interesi më të lartë se niveli aktual i tregut, do të rregullohet në zbritje deri në nivelin e tregut.

Nisur nga mungesa e të dhënave dhe dokumentave sqarues, të kërkuara nëpërmjet shkresave të sipërcituara lidhur me përllogaritjen e kostos së borxhit për vitin 2022, vlerësojmë se ky komponent nuk mund të përllogaritet drejtë.

Normës mesatare të interesit të borxhit, e përllogaritur nga ERE në vitin 2015 mund të vijojë të konsiderohet dhe për këtë vit dhe do të rishikohet në periudhën e ardhshme rregullatore mbështetur në të dhëna faktike dhe evidencat e justifikuara financiare.

Kosto mesatare e ponderuar e kapitalit (WACC)

Shoqëria OSSH sh.a ka paraqitur në aplikim përllogaritjen e Peshës Mesatare të Ponderuar të Kostos së Kapitalit (WACC) për vitet 2021 – 2022 sipas tabelës në vijim:

Zëri	2021	2022
Norma e interesit të borxhit të vjetër	2.41%	2.41%
Norma e interesit të borxhit të ri	0.88%	0.88%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	17.81%	17.81%
Borxhi i vjeter %	33.05%	33.05%
Borxh i ri %	26.95%	26.95%
Raport i synuar i kapitalit te vet	40.00%	40.00%
Kthim për borxhin e vjeter	0.80%	0.80%
Kthim për borxhin e ri	0.24%	0.24%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	7.12%	7.12%
WACC	8.16%	8.16%

OSSH deklaroi se Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet (AROE) bazuar në publikimet online të Univesitetit të Nju Jork nga profesor Adamodar për risqet si dhe nga raporti ECRB 2019 (përdorur edhe nga Enti Rregullator i Kosoves) për koeficientin beta, është llogaritur si me poshte:

$AroE = (Rfr + CPR + Beta * ERP) / (1 - T)$	17.81%
<i>Rfr</i> - norma nomimale e kthimit për letrat me vlerë me risk zero	1.70%
<i>CPR</i> – risku i vendit	4.36%
<i>Beta</i> (koeficient) për kapitalin e vet	100%
<i>ERP</i> – primi i riskut të kapitalit të vet.	9.08%
<i>T</i> - Tatimi mbi fitimin (15%)	15.00%

http://pages.stern.nyu.edu/~adamodar/New_Home_Page/datafile/ctryprem.html

Country	Moody's rating	Adj. Default Spread	Equity Risk Premium	Country Risk Premium	Corporate Tax Rate
Albania	B1	3.98%	9.08%	4.36%	15.00%

ERE ka kërkuar informacion nga OSSH lidhur me përllogaritjet e normës së lejuar të kthimit mbi kapitalin e vet.

OSSH është shprehur se është një shoqëri aksionere dhe jo buxhetore dhe si e tillë, Risku i vendit është pjesë e llogaritjes së kostos së kredive të marra nga bankat Shqiptare, te cilat e heqin këtë risk vetëm në rastet kur është përdorur garancia sovrane me miratim të posaçëm të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë si dhe ky risk është pjesë e përlllogaritjes së tarifave edhe në republikën e Kosovës, pranuar gjithashtu nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë (ECRB).

Pasi konsultuam burimin e të dhënave nëpërmjet linkut të cilësuar më lart, konstatuam se të dhënat e paraqitura në aplikim lidhur me ARoE, janë të ndryshme nga ato të publikuara në të njëjtin link. Të dhënat e përditësuara, krahas atyre të paraqitura në aplikim, evidentohen në vijim:

Të dhënat e përditësuara sipas publikimeve te fundit			
<i>Country</i>	<i>Adj. Default Spread</i>	<i>Equity Risk Premium</i>	<i>Country Risk Premium</i>
Albania	3.98%	8.69%	4.45%

Të dhënat e paraqitura në aplikim			
<i>Country</i>	<i>Adj. Default Spread</i>	<i>Equity Risk Premium</i>	<i>Country Risk Premium</i>
Albania	3.98%	9.08%	4.36%

Ndryshimi i treguesve sipas burimit të cilësuar më lart, krijon pasiguri lidhur me kryerjen e vlerësimeve të drejta për llogaritjen e Kthimit të lejuar mbi kapitalin e vet të përdorur nga OSSH sh.a. e si rrjedhojë dhe në përlllogaritjen e WACC në tërësi.

Për të vlerësuar mbi normat e aplikuara nga OSSH sh.a. i jemi referuar bazës së të dhënave të tarifave të ERRA për vendet e rajonit dhe më gjërë, të cilat i paraqesim në formë tabelare si më poshtë:

	Albania	Austria	Croatia	Czech Republic	Estonia	France	Georgia	Hungary	Kosovo	Latvia	Lithuania	Moldova	North Macedonia	Poland	Romania	Slovakia	Turkey
Weighted Average Cost of Capital	7.8	4.88	4.03	5.387	4.61	n.d.	10.01	4.69	8.3	3.31	5.34	6.02	5.81	5.5	6.39	5.81	14.6
WACC Year	2014	2016	2018	2015	2020	2000	2017	2016	2018	2019	2020	2020	2017	2019	2020	2019	2018
Beta (β), equity	1.32	0.85	0.38	0.901	0.706	n.d.	0.84	0.73	1	0.73	0.72	0.28	1	0.72	0.7	1.1145	1.06
ERP	6.58	5	4.13	5	5	5.2	6.17	4.3	4.5	5.41	7.06	5.22	2.73	n.d.	6.5	6.66	9.27
Corporate tax rate (t)	n.d.	25	18	19	20	26.47	15	19	10	20	15	12	10	19	16	21	22

ERP – primi i riskut të kapitalit të vet, varion nga vendi në vend. Sikurse vërehet nga tabela e mësipërme, niveli më i ulët i vlerësuar shkon nga 2.73%, i cili i korrespondon Maqedonisë deri në 9.27% normë që i përket Turqisë. Përcaktimi i fundit i këtij parametri nga ERE, ka ndodhur më në vitin 2011 nëpërmjet deklaratës rregullore dhe bazuar në të dhëna dhe referenca të justifikuar ka rezultuar në nivelin 6.58%.

Nga ana tjetër, bëhej e nevojshme të rikonsideroheshin treguesit në periudhën e ardhshme, duke i rillogaritur ato për një periudhë rregullatore më të gjatë se sa ajo prej 1 - viti, e propozuar nga OSSH sh.a. në këtë aplikim.

Për këtë arsye, ERE kërkoi prej OSSH rishikimin e periudhës rregullatore në përputhje me metodologjinë e tarifave të shpërndarjes (periudhë rregullatore 3 vjeçare)

Në përgjigje të sa më sipër, OSSH u shpreh se parashikimi dhe aplikimi i një periudhe rregullatore 3 – vjeçare nuk mundësohet për shkak të rritjes së jashtëzakonshme të cmimeve në tregun e energjisë gjatë vitit 2021, efektet e të cilave pritet të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2022.

Meqënëse periudha rregullatore e propozuar prej OSSH sh.a., është 1- vjeçare, vlersojmë të arsyeshme mbajtjen e të njëjtës normë të WACC e miratuar nga ERE në nivelin 7.81%. Kjo normë do të rishikohet në momentin që shoqëria do të aplikojë për një periudhë rregullatore më të gjatë në të cilën secili komponentë përlllogaritës do të rivlerësohet bazuar në praktikat më të mira rregullatore

Nga vlerësimet sa më sipër, fitimi i shoqërisë për vitin 2022 përlllogaritet si vijon

Zëri	Miratuar nga ERE 2015	2020 FAKT	OSHEE 2021 PARASHIKIM-1	OSHEE 2022 PARASHIKIM	ERE 2021	ERE 2022
RAB	13,874,904	30,517,183	53,242,249	61,768,046	30,829,215	33,404,212
WACC	7.81%	7.81%	8.16%	8.16%	7.81%	7.81%
Fitimi	1,084,063	2,384,345	4,343,324	5,038,830	2,408,724	2,609,912

Kosto mesatare e ponderuar e kapitalit prej 7.81% i mundëson OSSH një kthim të arsyeshëm mbi bazën e rregulluar të asetëve prej rreth 2.6 miliard lekë, të cilat lejojnë kryerjen e investimeve dhe vijimësinë e aktivitetit të shoqërisë për vitin 2022.

Theksojmë se ky komponent do të rivlerësohet përsëri në periudhën e ardhshme ashtu si dhe çdo komponentë tjetër i CAPEX mbështetur në përcaktimet e Metodologjisë së tarifave.

Në përfundim të ardhurat e aktivitetit të shpërndarjes, reduktohen edhe me të ardhurat që parashikohen të faturohen për :

- **Të ardhurat nga Lidhjet e Reja për periudhën 2015 - 2021 dhe parashikimin për vitin 2022**

Lidhur me këto të ardhura, janë kryer verifikimet përkatëse sipas të dhënave të pasqyruara në pasqyrat financiare të shoqërisë OSHEEE sh.a për periudhën 2015 - 2019, pasqyrat financiare të OSSH për vitin 2020, ndërkohë që për vitet 2021 dhe 2022 janë pranuar vlerat e konsideruara nga shoqëria si vlera të përafërta me trendin e realizuara të këtyre të ardhurve. Vlerat përkatëse paraqiten si vijon:

Zëri	Miratuar nga ERE 2015	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021 PARASHIKIM	2022 PARASHIKIM
Të ardhura nga lidhjet e reja	- 399,000	- 645,104	- 540,865	- 649,137	- 652,914	- 642,384	- 532,050	- 532,075	- 532,075.0

- **Të ardhura nga energjia reaktive për çdo vit të periudhës 2015 - 2021 dhe parashikimi për vitin 2022**

Shoqëria OSSH sh.a në aplikimin e saj ka kërkuar miratimin e një çmimi prej 1.92 lekë/kVArh të faturimit të energjisë reaktive për vitin 2022, duke përllogaritur këtë tarifë nga vlerësimi i saj për të ardhurat që pret të gjenerojë kundrejt sasisë së energjisë reaktive.

ERE me shkresën Nr. 177 Prot, datë 26.01.2022, ka kërkuar nga shoqëria paraqitjen e përllogaritjeve së bashku me informacionin mbështetës, mbi të cilin bazohet propozimi për çmimin e faturimit të energjisë reaktive prej 1.92 lekë/kVAhr për vitin 2022, duke sjellë në konsideratë se shoqëria OSSH sh.a me shkresën Nr. 4908/3 Prot, datë 23.08.2021, ka paraqitur përllogaritjen e kostove të shkaktuara nga energjia reaktive në rrjetin e shpërndarjes, duke u bazuar në programin “DigSILENT Power Factory 2020”.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, OSSH sh.a. me shkresën nr. 801/1 Prot., datë 22.02.2022 ka përcjellë informacionin e kërkuar nga ERE, i cili paraqitet si vijon:

- Të dhënat e përdorura nga shoqëria për këtë llogaritje i përkasin vitit 2021. Sipas deklarimeve gjatë vitit 2021, në rrjetin e OSSH Sh.a, ka qarkulluar energji reaktive e matur për $\cos\phi < 0.9$ sasia prej 229,174,198 kVArh.

NIVELI I TENSIONIT	ENERGJI AKTIVE 2021	ENERGJI REAKTIVE 2021
35KV	10,751,434	5,728,954
20/10/6KV	308,252,917	167,425,836
0.4KV	101,694,156	56,019,407
GRAND TOTAL	420,698,507	229,174,198

- OSSH është shprehur se për të qartësuar efektin negativ në nivelin e humbjeve teknike, që energjia reaktive shkakton në rrjetin e shpërndarjes, ka përdorur programin Digisilent Power Factory 2020, certifikuar sipas ISO 9001:2015, duke përllogaritur $\cos\phi$ në bazë të parametrave teknik për linjat e çdo niveli tensioni.
- Nga kjo analizë, shoqëria ka paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme, humbjet teknike për secilën linjë dhe $\cos\phi$ përkatëse për çdo nivel tensioni sipas parametrave mesatare teknike të këtyre linjave dhe sasisë së energjisë që qarkullon në to:

UN	Gjatesia e linjes Km	Humbjet teknike ne %	CosØ
35 kV	22	2.17%	0.84
20/10/6KV	5	5.24%	0.89
0.4 kv	0.2	4.50%	0.86
		3.97%	0.86

- Për rrjedhojë sipas këtyre të dhënave dhe volumit të energjisë aktive që qarkullon në rrjet për energjinë reaktive të matur, kur $\cos\phi < 0.9$, për çdo nivel tensioni do të kemi rezultatin si më poshtë:

UN	Humbjet teknike ne %	Energjia aktive per nivel tensioni kwh	Humbjet e energjise aktive kwh (Energjia aktive * Humbje teknike)	% e Humbjeve (Humbjet e energjise aktive/Energji aktive)
35 kV	2.17%	10,751,434	233,588	2.17%
20/10/6KV	5.24%	308,252,917	16,152,453	5.24%
0.4 kv	4.50%	101,694,156	4,574,208	4.50%
		420,698,507	20,960,249	4.98%

- Duke iu referuar Bilancit Energjitik të vitit 2021, shoqëria deklaroi se humbjet teknike totale në vlerë absolute janë 1,028,670 MWh dhe sipas përlogaritjeve çmimi që OSSH Sh.a duhet të faturojë për energjinë reaktive të matur për përdoruesit e rrjetit me $\cos\phi < 0.9$, të jetë 1.92 Leke/kVArh

1. Humbjet ne rrjetin e OSSH per vitin 2021 (kwh)	1,028,670,000.00
2. Pesha e Humbjeve te shkaktuara nga Energjia reaktive ne totalin e humbjeve kwh (1*4.98%)	51,279,199.50
3. Shpenzimi i OSSH per kete sasi energjie gjatë vitit 2022 (Leke) (2*8.5652 Leke)	439,216,600
4. Sasia totale e energjise reaktive te matur me $\cos\phi < 0.9$ (kvarh)	229,174,198
CMIMI I ENERGJISE REAKTIVE (3/4)	1.92

Lidhur me sa paraqitur nga shoqëria, evidentojmë se propozimi i ardhur nga OSSH sha ka paraqitur një përlogaritje, e cila është në përputhje me parimet e llogaritjes së humbjeve të energjise elektrike. Gjithashtu, miratimi i një çmimi të unifikuar të energjise reaktive për të gjitha nivelet e tensionit, duke u bazuar mbi kostot që i shkaktohen operatorit të rrjetit nga përdoruesit të cilët nuk arrijnë normën e faktorit të fuqisë prej 0.9, siç përcaktuar në VKM nr. 109/2006, do të vazhdojë të jetë i bazuar mbi parimet e ERE-s për miratimin e tarifave dhe çmimeve, duke reflektuar sa më drejtë kostot si dhe duke qënë jodiskriminues dhe transparent.

Për gjithë sa më sipër, vlerësojmë të pranojmë propozimin e shoqërisë OSSH sh.a. për çmimin e faturimit të energjise reaktive për vitin 2022, prej 1.92 lekë/kVAhr.

Për sa i përket periudhës 2015 – 2021, shoqëria OSSH ka realizuar të ardhura nga energjia reaktive, si më poshtë vijon:

Zëri	Miratuar nga ERE 2015	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021 PARASHIKIM	2022 PARASHIKIM
Të ardhurat nga energjia reaktive	- 253,000	- 338,190	- 333,993	- 336,922	- 338,933	- 372,863	- 394,002	- 394,002	- 420,560

Te ardhurat e realizuara nga energjia reaktive, janë konsideruar si të ardhura të zbritshme dhe janë përfshirë në përlogaritjet e tarifës së shpërndarjes për vitin 2022.

- Të ardhura nga Shërbime fikse të tarifuar për konsumin "0 kWh" për periudhën 2015-2021**

Lidhur me të ardhurat nga shërbimet fikse, shoqëria sqaron se: *ndodhet në fazë transformimi rrënjesor ku kostot e mirëmbajtjes së rrjetit janë akoma shumë të larta për shkak të mungesës së investimeve të nevojshme dhe zëvendësimit të paisjeve për një kohë të gjatë. Për këtë shkak mendojmë se kosto e tanishme e mirëmbajtjes është e lartë dhe nuk përfaqëson kostot normale*

te mirëmbajtjes te cilat do të mundësonin llogaritjen e drejtë të tarifës, prandaj edhe pse me e ulet se kostot aktuale te mirembajtjes, propozojme qe Tarifa e Mirembajtjes në "Zero Kwh", të mos ndryshoje.

ERE me anë të shkresë Nr.925/5 Prot, datë 26.11.2021 kërkoi nga OSSH sh.a. paraqitjen e kostove të mirëmbajtjes së rrjetit të shpërndarjes, për të përcaktuar një tarifë kosto-reflektuese për mirëmbajtjen e përdoruesve të rrjetit pa konsum.

Shoqëria u shpreh se: *Rishikimi i kostos për mirëmbajtje për përdoruesit e rrjetit pa konsum nuk ishte pjese e perlllogaritjeve të paraqitura dhe kërkon një studim të veçantë dhe kohën e nevojshme per kryerjen e tij. OSSH do te kryeje një studim lidhur me kostot e kesaj kategorie klientësh dhe do të propozojë ndryshim të kësaj tarife.*

Sa më sipër në vijim paraqiten të ardhurat e gjeneruara ndër vite nga ky burim:

Zëri	Miratur nga ERE 2015	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021 PARASHIKIM	2022 PARASHIKIM
Te ardhura nga Shërbime fikse te tarifuar per konsumin "0 kWh"		- 612,898 -	- 625,197 -	- 573,910 -	- 593,233 -	- 636,050 -	- 676,560 -	- 639,804 -	- 639,804 -

Mbështetur në deklaratimet e OSSH sh.a. në lidhje me të ardhura nga Shërbime fikse të tarifuar për konsumin "0 kWh", vlerësojmë që për aq kohë sa shoqëria nuk ka kryer një studim për përlllogaritjen e një tarife fikse dhe kosto reflektuese të matjes dhe leximit për konsumin "0 kWh", vlera e vetme përfaqësuese e të ardhurve të gjeneruara nga ky shërbim mund të meret ajo propozuar nga OSSH. Te ardhurat e realizuara nga ky shërbim, jane konsideruar si të ardhura të zbritshme dhe janë përfshirë në përlllogaritjet e tarifës së shpërndarjes për vitin 2022.

- **Të ardhurat nga dëmi ekonomik**

Nga raportimet periodike të OSSH për periudhën 2020 - 2021 është konstatuar se Shoqëria evidenton në bilancin energjistik dhe sasine e demit ekonomik të faturuar. Fillimisht ERE me shkresën Nr. 925/5 Prot, datë 26.11.2021, kërkoi nga OSSH paraqitjen e të ardhurave të realizuara nga vendosja e demit ekonomik për vitet 2020 – 2021, të evidentuara për çdo nivel tensioni.

OSSH deklaroi se të ardhurat nga Dëmi Ekonomik për vitin 2020 ishin 415,372 mijë Lekë, ndersa ato të realizuara per periudhen Janar - Tetor 2021 ishin 270,464 mijë Lekë.

Në zbatim të nenit 9, pika 1, të "Metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e demit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike", të miratur me Vendimin Nr. 232, datë 20.12.2019, të Bordit të ERE-s, dëmi ekonomik do të jetë kundërvlehtë në lekë e sasisë së energjisë elektrike e shprehur në kwh energji aktive, e kërkueshme prej OSSH ndaj përdoruesit të rrjetit, e cila përfaqëson energjinë elektrike të konsumuar pa autorizim nga ky i fundit.

Në kuptim të sa më sipër dhe në kohën kur OSSH gjeneron të ardhura nga faturimi i demit ekonomik, ato duhet të njihen në zbritje të të ardhurave të kërkuara, duke marrë në konsideratë se në të ardhurat e kërkuara për vitin 2022 do të njihen dhe korigjimet e kostove të humbjeve për periudhën, 2015 - 2021 në zbatim të përcaktimeve të VKM Nr.758/2021, çdo e ardhur

shtesë është e arsyeshme të zbritet nga të ardhurat e shoqërisë në mënyrë që të transferohet tek konsumatorët fundorë.

Në vijim paraqesim të ardhurat e realizuara nga faturimi i dëmit ekonomik për periudhën 2020-2021

Zëri	Miraturar nga ERE 2015	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021 PARASHIKIM	2022 PARASHIKIM
Te ardhura demit ekonomik							415,372	270,464	270,464.00

Për vitin 2022, meqënëse kjo e ardhur nuk është e matshme në kohë, vlersojmë të konsiderohet vlera e realizuar prej shoqërisë për vitin 2020 si dhe ajo e realizuar për periudhën Janar - Tetor 2021 prej 270,464, vlerë e cila konsiderohet e zbritshme dhe për vitin 2022. Të ardhurat nga dëmi ekonomik do të korigjohen sipas vlerës së tyre reale në periudhën e ardhshme rregullatore.

Kompensimi I humbjeve të realizuara të periudhës 2015-2021

OSSH pretendon që në korigjimin e të ardhurave të njihet diferenca e humbjeve faktike në rrjetin e shpërndarjes për periudhën 2015 – 2021, të njohura me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 253/2019, i ndryshuar, me ato të njohura në tarifën e miratur nga ERE. Shoqëria OSSH sh.a deklaron se vlera e përcaktuar nga aplikimi i tarifave aktuale për periudhën 2015 – 2021 është përllogaritur në vlerën 14.03 miliard Lekë dhe është parashikuar të aplikohet si një korigjim në tarifën mesatare të shpërndarjes prej 2.8 miliard Lekë për 5 vitet e ardhshme 2022 - 2026.

Në aplikim shoqëria ka përcjellë përllogaritjen e korigjimit sipas tabelës në vijim:

Korigjimi i Të Ardhurave nga humbjet e njohura me VKM të re.

<i>Bilanci energjistik (Mwh)</i>	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Energji në Rrjet	6,494,866	6,399,716	6,498,321	6,436,911	6,805,811	6,785,136
Energji e Blerë nga Furnizuesit		6,399,716	6,498,321	6,422,287	6,535,222	6,537,957
Energji e Shitur FSHU	4,459,444	4,605,265	4,781,998	4,883,784	5,052,261	5,080,217
Energji kthyer nga HEC tek OST					229,380	180,053
Energji e Shitur Klientë të tjerë		-		14,624	41,209	67,126
Humbje (Mwh)	2,035,422	1,794,451	1,716,323	1,538,503	1,482,962	1,457,740
Humbje %	31.34%	28.04%	26.41%	23.90%	21.79%	21.48%
Humbje të Njohura sipas VKM	31.30%	28.00%	26.40%	23.90%	21.80%	21.50%
Humbje të njohura sipas ERE	21.04%	21.04%	21.04%	21.04%	21.04%	21.04%
Diferenca humbje për tu njohur %	10.26%	6.96%	5.36%	2.86%	0.76%	0.46%
Diferenca humbje për tu njohur (Mwh)	666,373	445,420	348,310	184,096	51,724	31,212
Cmimi i Importit (Lekë/Kwh)	9.09	5.82	8.22	9.92	9.16	6.95
Korigjimi i të ardhurave sipas viteve (000/Lekë)	6,058,249	2,593,035	2,863,872	1,826,060	473,639	216,922
Vlera totale për tu korigjuar (000/Lekë)						14,031,776
Periudha në vjet						5
Korigjim vjetor						2,806,355

Në zbatim të metodologjisë, korigjimi i të ardhurave duhet të konsiderojë si faktor axhustues faktorët e rregullimit të vlerësuar/parashikuar, të cilët do të përfshihen në çdo vit të periudhës së rregullimit.

Faktoret të cilët duhet të konsiderohen përshijnë:

- Bazën mesatare vjetore kumulative të aseteve të rregulluar për periudhën rregullatore;
- Humbjet totale të energjisë;
- Faktorin vjetor të inflacionit dhe Faktorin vjetor të përmirësimit të eficiencës I cili në rastin konkret është vlerësuar 0.
- Të ardhurat mbi/nën kërkesën e lejuar të periudhave të mbylluara rregullatore

Vleresojmë se metoda e aplikuar nga OSSH sh.a. si më lartë për llogaritjen e kostos së humbjeve të realizuara në rrjetin e shpërndarjes nuk është e mbështetur në parashikimet e Metodologjisë.

Në zbatim të Metodologjisë, janë kryer vleresimet e të ardhurave të realizuara, të cilat kanë përcaktuar tarifën mesatare të shpërndarjes të miratuara nga ERE për vitin 2015 dhe të lënë në fuqi për çdo vit të periudhës paraardhëse 2015-2021, duke u mbështetur në të dhënat e pasqyrave financiare të shoqërive OSHEE sh.a dhe OSSH sh.a, raportimeve të dërguara gjatë viteve si dhe dokumentacionit plotësues të depozituar në kuadër të aplikimeve për tarifën të operatorit të shpërndarjes.

Për të vlerësuar më drejtë mbi përlllogaritjen e kostos së blerjes së humbjeve, ERE me anë të shkresës Nr.925/5 Prot, datë 26.11.2021, kërkoi dërgimin e kostos së blerjes së energjisë nga secili burim, çmimet respektive dhe koston e transmetimit të humbjeve çdo vit të periudhës 2015-2020, së bashku me parashikimin e shoqërisë për realizimin e tyre për periudhën 2021-2022.

Me shkresën Nr.10691/1 Prot, datë 14.12.2021, OSSH sh.a dërgoi të dhënat lidhur me koston e blerjes së humbjeve, për periudhën 2015-2020 dhe parashikimet e saj për periudhën 2021-2022 dhe koston e transmetimit të humbjeve për këtë periudhë.

Kosto e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve e dërguar me shkresën sipërcituar konstatohet se ka ndryshime të theksuara në vlerën përlllogaritëse të paraqitur në aplikim. Në aplikim, OSSH për diferencat e rezultuara nga ndryshimi i targetit të humbjeve ka konsideruar vetëm çmimin e importit. Ndërkohë, nga të dhënat e përcjella me shkresën sipërcituar, cmimi i blerjes së humbjeve evidentohet i ndryshëm dhe i ndarë sipas burimeve të përdorura për mbulimin e tyre.

Kosto e blerjes së energjisë sipas shkresës nr.10691/1, datë 14.12.2021 për periudhën 2015-2021, evidentohet si vijon:

		2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
		Shperndarje	Shperndarje	Shperndarje	Shperndarje	Shperndarje	Shperndarje	Shperndarje
Energji Gjithsej	Kwh	2,035,422	1,794,451	1,716,323	1,538,503	1,482,962	1,520,319	1,569,957
Nga Ashta	Kwh		114,427	174,527	298,107	191,495	186,028	294,130
Nga HEC private	Kwh		365,077	833,429	929,053	933,143	898,512	1,025,029
Nga Burime te Rinovueshme	Kwh		0	0		22,196	32,265	42,156
Nga Tregu i Lire	Kwh	2,035,422	1,314,947	708,367	311,342	336,128	403,515	208,643
Nga Ashta	Lekë/Kwh		8.26	8.02	8.01	7.63	7.59	7.74
Nga HEC private	Lekë/Kwh		7.45	7.45	8.57	8.46	7.88	7.45
Nga Burime te Rinovueshme	Lekë/Kwh		-	-	-	12.27	12.41	12.25
Nga Tregu i Lire	Lekë/Kwh	6.40	5.82	8.22	9.92	9.16	6.69	19.89
Nga Ashta	Lekë		945,170	1,400,052	2,386,647	1,460,863	1,412,379	2,276,348
Nga HEC private	Lekë		2,719,093	6,207,378	7,957,529	7,892,707	7,077,864	7,634,414
Nga Burime te Rinovueshme	Lekë		-	-	-	272,403	400,447	516,543
Nga Tregu i Lire	Lekë	13,035,606	7,655,028	5,824,331	3,088,230	3,080,050	2,700,870	4,149,624
Kosto Totale	Lekë	13,035,606	11,319,291	13,431,761	13,432,405	12,706,024	11,591,560	14,576,929

Të dhënat e paraqitura janë krahasuar dhe me të dhënat të cilat janë dërguar në ERE nëpërmjet raportimeve periodike nga shoqëria në kuadër të aplikimeve për tarifa të periudhave të mëparshme ushtrimore. Konstatohet se sasia e humbjeve të vlerësuara nga OSSH për vitin 2020 është e ndryshme nga ajo e realizuar praktikisht dhe dërguar nga OSSH nëpërmjet raportimeve periodike. Në vitin 2020, sasia e humbjeve të realizuara ka qenë 1,457,774 MWh, ndërsa shoqëria ka kërkuara nëpërmjet shkresës sipërcituar ti njihet vlera prej 1,520,319 MWh.

Gjithashtu konstatohet se në tabelën ku evidentohen shpenzimet e transmetimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike për periudhën 2015 - 2019, është konsideruar kosto e transmetimit për të gjithë sasinë e energjisë elektrike të përdorur për mbulimit të humbjeve, duke mos zhitur sasinë e energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e lidhura ne njetin e shpërndarjes, energjia e te cilëve destinohet për mbulimin e humbjeve ne rrjetin e OSSH dhe që nuk i shkakton shoqërisë kosto transmetimi të energjisë elektrike.

Kosto e transmetimit të humbjeve e dërguar nga OSSH evidentohet në tabelën në vijim:

		2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021 (10-mujor)	2021 (Nent-Dhjet)	2021 Total	2022
Tarifa e transmetimit	Lekë/MWh	0.65	0.65	0.65	0.75	0.75	0.75	0.75	0.75	0.75	0.75
Shpenzime transmetimi	000/Lekë	1,323,024	1,166,393	1,115,610	1,153,877	1,112,221	801,106	602,979	119,693	722,672	664,679

Nga sa më sipër, ERE me anë të shkresës Nr.177 Prot, date 26.01.2022, kërkoj nga OSSH sh.a. të paraqesë vlerën e saktë të shpenzimeve të transmetimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve si dhe një bilanc energjitik, ku të evidentohet energjia e prodhuar nga HEC-et private, e ndarë sipas prodhimit në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, e cila ka shkuar për mbulimin e humbjeve të rrjetit sipas periudhave të lartpërmendura.

OSSH sh.a. me anë të shkresës Nr.801/1 Prot, datë 22.02.2022, ka deklaruar se në periudhën 2015 -2019 shoqëritë nuk kanë qënë të ndara dhe faturimi i tarifës së transmetimit për OSSH sha mungon, prandaj edhe **llogaritjet janë konvencionale.**

Për sa më sipër, ERE ka kryer vlerësimet e saj mbështetur në modelin e tregut të energjisë elektrike, ka përllogaritur koston e mbulimit të humbjeve duke konsideruar sasinë e raportuara nga OSSH dhe të përfshira në bilancin energjitik, burimin e energjisë së përdorur dhe cmimet përkatëse të realizuara për periudhën 2015-2021.

Në lidhje me koston e transmetimit të energjisë për mbulimin e humbjeve pasi janë vlersuar burimit e prokurimit të tyre, është aplikuar tarifa e transmetimit në fuqi për periudhën 2015 - 2021 për energjinë e prodhuar nga HEC Ashta, HEC-et e lidhur në transmetim si dhe sasinë e energjisë e cila është importuar për arsye të plotësimit të diferencës nga këto burime me qëllim mbulimin e humbjeve.

Për vitin 2021, pas dërgimit të raportit periodik vjetor të OSHEE Group nëpërmjet shkresës Nr. 1425 Prot, datë 10.02.2022, në të njëjtën formë u rivlerësua dhe kosto e humbjeve të vitit 2021.

Kosto e mbulimit të humbjeve për periudhën 2015 – 2021, e përlogaritur nga ERE, paraqitet sipas tabelës në vijim:

Pershkrimi	Njesia	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Energji Gjithsej	Kwh	2,035,422	1,794,451	1,716,323	1,538,503	1,482,962	1,457,774	1,548,235
Nga Ashta	Kwh		114,427	174,527	298,107	191,495.0	93,099	77,128
Nga HEC private	Kwh		365,077	879,389	1,240,396	933,143.0	1,080,583	1,258,123
Nga Burime te Rinovueshme	Kwh		0	0		22,196.0	17,720	17,824
Nga Tregu I Lire	Kwh	2,035,422	1,314,947	662,407		336,128	266,373	195,160
Nga Ashta	Lekë/Kwh		8.06	8.03	8.01	7.63	7.59	7.75
Nga HEC private	Lekë/Kwh		7.45	7.45	8.57	8.46	7.87	7.45
Nga Burime te Rinovueshme	Lekë/Kwh		-	-		12.28	12.41	12.25
Nga Tregu I Lire	Lekë/Kwh	6.40	5.82	8.94	9.41	9.23	6.69	20.11
Nga Ashta	Lekë		922,284	1,401,449	2,386,647	1,461,873	706,993	597,743
Nga HEC private	Lekë		2,719,093	6,549,693	10,624,240	7,892,710	8,504,186	9,370,504
Nga Burime te Rinovueshme	Lekë		-	-	-	272,567	219,903	218,343
Nga Tregu I Lire	Lekë	13,035,106	7,652,993	5,921,914	-	3,103,806	1,782,035	3,924,658
Kosto Totale	Lekë	13,035,106	11,294,370	13,873,056	13,010,886	12,730,956	11,213,117	14,111,248

Kosto e transmetimit të humbjeve për periudhën 2015-2021 e përlogaritur nga ERE, paraqitet sipas tabelës në vijim:

Pershkrimi	Njesia	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Sasi e marrë nga rrjeti i transmetimit	MWh	2,035,421.76	1,794,451.44	1,244,764.81	953,162.03	814,400.33	856,816.00	926,645
Tarifa e transmetimit	Lekë/Kwh	0.65	0.65	0.65	0.75	0.75	0.75	0.75
Shpenzime transmetimi	Lekë	1,323,024.1	1,166,393.4	809,097.1	714,871.5	610,800.2	801,106.0	694,984

Në përlogaritjen e tarifës mesatare të shpërndarjes prej 4.79 lekë/kWh, ERE konsideroi nivelin e humbjeve prej 21.04% qe parashikohej te arrihej per vitin 2015, nivel i cili shkonte në të njëjtën linjë me përpjekjet dhe masat e mara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë per uljen e humbjeve joteknike. Ky objektivi u parashikua dhe nëpërmjet VKM Nr. 171, datë 25.2.2015 “Për Miratimin E Planit Të Rimëkëmbjes Financiare Të Sektorit Të Energjisë Elektrike”.

VKM Nr. 758/2021, ka rishikuar targetet e humbjeve të OSSH për periudhën 2014 - 2026 sipas tabelës ne vijim:

	Humbjet totale (%)
2014	37.8
2015	31.3
2016	28.0
2017	26.4
2018	23.9
2019	21.8
2020	21.5
2021	20.5
2022	19.6
2023	19.0
2024	18.5
2025	18.1
2026	17.8

Për sa më sipër, janë kryer përlogaritjet e kostos së humbjeve dhe kostos së transmetimit të humbjeve të realizuara mbi targetin e vendosur në vitin 2015 sipas parashikimeve të VKM sipërcituar, krahas kostove të njohura nga ERE për llogaritjen e tarifës mesatare të shpërndarjes për vitin 2015, e cila është lënë në fuqi sipas vendimmarrjeve respektive të ERE si vijon:

Kosto e blerjes së humbjeve	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Total Mbi target
<i>Kosto e transmetimit për humbjet</i>	1,323,024	1,166,393	809,097	714,872	610,800	801,106	694,984	
<i>Kosto e transmetimit për humbjet e njohur nga ERE në vitin 2015</i>	787,028	787,028	787,028	787,028	787,028	787,028	787,028	
<i>Kosto e transmetimit për humbjet mbi target sipas VKM 253</i>	535,996	379,365	22,069	72,157	176,228	14,078	92,044	611,079
Kosto e humbjeve Totale	13,035,106	11,294,370	13,873,056	13,010,886	12,730,956	11,213,117	14,111,248	
<i>Kosto e humbjet e njohur nga ERE në vitin 2015</i>	9,323,257	9,323,257	9,323,257	9,323,257	9,323,257	9,323,257	9,323,257	
<i>Kosto e për humbjet mbi target sipas VKM 253</i>	3,711,849	1,971,113	4,549,799	3,687,630	3,407,699	1,889,860	4,787,991	24,005,941
				Total 2015-2019	18,017,136		Total 2015-2021	24,617,020
Të ardhura të korigjueshme nga aktiviteti i furnizimit universal që kanë shërbyer për mbulimin e humbjeve mbi target	2015	2016	2017	2018	2019			
	-6,097,494.41	-7,308,667.01	2,624,994.53	-4,274,065.21	2,735,429.45			
				Total 2015-2019	-12,319,803			

Sikurse vërehet në tabelën e mësipërme, kosto e blerjes së humbjeve mbi target dhe kosto e transmetimit të humbjeve arrin në vlerën 24.6 miliard lekë.

Bordi i ERE-s me anë të Vendimit Nr. 190/2018, është shprehur se *Nga raportimi i strukturës së shitjes për vitet 2015 -2017 rezulton që çmimi mesatar i realizuar nga shitja është më i lartë nga ai miratuar prej 10.7 lekë/kWh, duke rezultuar me të ardhura shtesë për shoqërinë. Këto diferenca vlerësohen të përdoren si rezervë për mbulimin e kapitalit negativ të trashëguar që nga viti 2014, duke i mundësuar shoqërisë aftësinë për likuidimin e detyrimeve si dhe mbulimin e kostove të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve mbi target.*

Si rrjedhojë, humbjet mbi target por dhe gjëndja e kapitalit negativ të shoqërisë OSHEE sh.a. për periudhën 2015-2019 të cilat arrijnë në vlerën 18 miliardë lekë, janë mbuluar nga të ardhurat e tepërta të realizuara nga shitja e energjisë prej aktivitetit të furnizimit të shërbimit universal, të cilat arrijnë në vlerën 12.3 miliard lekë. Për efekt të korigjimit të të ardhurave të kërkuara për vitin 2022 është njohur Kosto e Blerjes së Humbjeve dhe Kosto e Transmetimit të Humbjeve mbi target për periudhën 2015 - 2021 sipas përcaktimeve të VKM Nr. 758/2021, në vlerën 24.6 miliard lekë.

Për vitin 2021 është përlogaritur dhe reflektuar diferenca e të ardhurave të kërkuara me ato të realizuara sipas të dhënave të pasqyrave financiare të vitit 2020, në mungesë të depozitimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2021.

Pasi janë konsideruar të gjithë elementët korigjues si:

- kosto e blerjes së humbjeve sipas secilit burim për cdo vit të periudhës 2015-2021 për sasine totale të humbjeve mbështetur në parashikimet e VKM-se nr. 758/2021;
- kosto e transmetimit për humbjet bazuar në përcaktimet e legjislacioni në fuqi për cdo vit të periudhës 2015-2021, sipas arsytetimeve të mësipërme dhe mbështetur në parashikimet e VKM-se nr. 758/2021;
- shpenzimet operative të ndara sipas Metodologjisë së ndarjes së shpenzimeve operative të shoqërisë OSHEE sh.a.;
- sasia e energjisë së lëvruar në rrjetin e shpërndarjes sipas bilancit energjistik për periudhën 2015-2021;
- baza e rregulluar e aseteve dhe amortizimi i akumuluar sipas arsytetimeve të mësipërme
- të ardhurat e zbritshme të realizuara nga aktiviteti ushtrimor sipas arsytetimeve të mësipërme
- të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i shpërndarjes së energjisë elektrike mbi/nën tarifave të shpërndarjes në fuqi për periudhën 2015-2021

vlera totale për t'u korigjuar në të ardhurat e kërkuara rezulton 6,180,009 mijë lekë.

OSSH sh.a. në përlogaritjet e saj ka kërkuar shpërndarjen dhe rekuperimin e kostos së humbjeve mbi target për një periudhë 5 - vjeçare.

Në vlerësimin tonë, kemi konsideruar se kjo vlerë duhet të shpërndahet në të ardhurat e kërkuara në 2 vitet e ardhshme, duke rezultuar në një korigjim vjetor të të ardhurave të kërkuara prej 3,090,005 mijë lekë, me qëllim rritjen e aftësisë likujduese për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar në kushtet e çmimeve tejet të larta të energjisë elektrike, shlyerjen e detyrimeve të prapambetura si dhe mbulimin e kapitalit negativ të trashëguar nga ndarja e shoqërisë.

Të ardhurat e kërkuara për vitin 2022

Të ardhurat kërkuara të OSSH sh.a. për vitin 2022 pas të gjitha arsytetimeve dhe vlerësimeve të mësipërme, rezultojnë sipas tabelës në vijim:

Të ardhurat e korigjueshme për periudhën Janar – Prill 2022

Meqënëse të ardhurat e kërkuara që priten të realizohen nga OSSH shtrihen për një periudhë 1 vjeçare dhe tarifatat e reja të shpërndarjes së energjisë elektrike priten të hynë në fuqi në 1 Maj 2022, për efekt të rekuperimit të të ardhurave të pafaturuara sipas arsytimit në këtë aplikim është përllogaritur diferenca e korigjueshme e të ardhurave të kërkuara për periudhën Janar-Prill 2022, e cila ka rezultuar në vlerën 1,588,953 mijë lekë.

Përllogaritja e kësaj vlere evidentohet si vijon:

Sasia	5,775,730
Tarifatat ne fuqi	4.79
Tarifa rezultuese per vitin 2022	5.62
Diference	0.83
Diference e të ardhurave nga tarifa rezultuese me tarifën mesatare në fuqi (12 mujore)	4,766,859
Diferencë e korigjueshme per periudhen 1 Janar-30 Prill (4 mujore)	1,588,953

Meqënëse llogaritjet për tarifën mesatare të shpërndarjes janë për të gjithë sasinë vjetore të energjisë që pritet të lëvrohet në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2022 dhe tarifatat e reja do të aplikohen për periudhën 1 Maj – 31 Dhjetor 2022, diferenca e korigjueshme për periudhën 1 Janar - 30 Prill 2022, është e nevojshme të reflektohet në rritje të tarifës mesatare të shpërndarjes për periudhën e mbetur të vitit 2022

Diferenca e korigjueshme do të rishikohet në zbritje në periudhën pasardhëse rregullatore kundrejt të ardhurave faktike për 4 mujorin e parë të vitit 2022 mbështetur në evidenca të justifikuara financiare.

Sa i takon komponentëve të tjerë të të ardhurave të kërkuara, ato do të korigjohen në periudhën pasardhëse rregullatore, në zbatim të përcaktimit të Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike.

Të ardhurat e kërkuara të OSSH për periudhën 1 maj -31 dhjetor 2022

Në vijim të arsytimit të mësipërme, të ardhurat kërkuara të shoqërisë OSSH për aktivitetin e shpërndarjes për periudhën 1 maj -31 dhjetor 2022, rezultojnë sipas tabelës së mëposhtme:

Sic vërehet më lartë tarifa mesatare e shpërndarjes për periudhën 1 maj – 31 dhjetor 2022 rezulton **5.89 lekë/kWh**.

Lidhur me klientët me pikë lidhje në TM dhe me matje në TU

Në seancën dëgjimore teknike të datës 03.12.2021, organizuar midis ERE dhe OSSH në kuadër të aplikimit për tarifën e rrjetit të shpërndarjes, ERE kërkoi sqarime prej shoqërisë lidhur me faktin se si do të trajtohen nga OSSH klientet të cilët kanë pikë lidhje në TM dhe matje në TU, Gjithashtu, nga ana e ERE-s u pritën propozimet e shoqërisë në lidhje me tarifën e shpërndarjes së këtyre klientëve.

OSSH është shprehur gjatë kësaj seance se:

Keta klientë do dalin në treg të lirë dhe po përgatitet informacioni përkatës. Kjo pjesë e evidentuar nuk është menduar akoma se si do të trajtohet në këtë material dhe është një çështje e cila meriton një trajtim të veçantë.

Në kuadër të këtij diskutimi, ERE me anë të shkresës Nr. 925/8 Prot, date 15.12.2021, kërkoi informacion dhe sqarime lidhur me kategorizimin e klientëve të cilët kanë pike lidhje në TM dhe matje në TU dhe kanë një çmim të ndryshëm të furnizimit me energji elektrike nga klientët e tjerë fundorë, të cilët janë të lidhur në TM ose TU. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me anë të shkresës Nr. 11226/2 Prot, datë 04.02.2022, OSSH është shprehur ndër të tjera se:

Llogaritjet në aplikim kanë përfshirë humbjen në nivel tensioni mbi të cilën ndertohen tarifën. OSSH siguron të ardhura vetëm nëpërmjet tarifave dhe nuk ka tarifë të veçante për TM - TU.

OSSH nuk ka përcjellë në këtë aplikim përlllogaritje të tarifës së shpërndarjes për klientët me pike lidhje në TM dhe matje në TU.

ERE me Vendimin Nr. 128/2016 të Bordit të ERE-s, ka miratuar çmimin për klientët e lidhur në TM dhe me matje në TU, prej 12.4 lekë/kWh për shitjen me pakicë të energjisë aktive (jo pik), i cili është lënë në fuqi dhe në periudhat pasardhëse.

Ky vendim është marrë në vijim të propozimit të shoqërisë OSHEE sh.a. për miratimin e këtij çmimi duke u bazuar në faktin se një pjesë e klientëve kanë kontrata të pikëlidhjes në TM por matësia të energjisë në pjesën pas paisjeve transformuese dhe transmetuese, të cilat janë në pronësi të tyre duke mos plotësuar gjatë investimit kushtet e plota për të kryer matje në tensionin sipas pikës së tyre të lidhjes. Shoqëria ka deklaruar se kjo menyrë lidhjeje dhe matje në rrjet shkakton humbje të shtuar të energjisë për sasinë që humbet në paisjet në zotërim të klientëve, për rrjedhojë edhe kosto shtesë, për të cilën ka paraqitur dhe një studim si pjesë e aplikimit për tarifën në atë periudhë.

Në relacionin e miratimit të vendimit lartpërmendur, ERE është shprehur se *bazuar në argumentimin teknik të kompanisë në aplikimin për tarifën, energjia e humbur në kabinat e transformimit prej 93,408 MWh përfaqëson një kosto të shtuar për t'u perballuar nga ana e OSHEE sh.a .. Si energji e humbur, ajo përfshihet në sasinë totale të humbjeve të energjisë në rrjetin e shpërndarjes prandaj e arsyetojmë të drejtë përfshirjen në koston shtesë të arsyeshme të kompanisë për të mbuluar nga kjo kategori konsumatorësh.*

Nisur nga këto arsye, kosto e përlogaritur për mbulimin e humbjeve ka rezultuar në një tarifë prej 1.4 lekë/kWh, e cila i pergjigjet humbjes në transformim për klientët e lidhur në TM e matje në TU në atë periudhë.

OSSH në aplikimin e paraqitur për tarifën e viti 2022 nuk ka evidentuar koston e shkaktuar nga këta klientë në rrjetin e shpërndarjes. Për rrjedhojë, në momentin që shoqëria do të aplikojë dhe përcjellë kostot që shkaktjnë këta klientë në rrjetin e shpërndarjes, do të kryen korrigjimet në periudhën pasardhëse, bazuar parashikimet e Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike.

Përlogaritja e tarifës për nivel tensioni

Në përlogaritjen e tarifave për nivel tensioni OSSH sh.a. dhe ERE janë mbështetur në parashikimet e VKM Nr. 253, datë 24.4.2019, e ndryshuar. Në këtë Vendim parashikohet se ERE duhet të miratojë tre tarifa të aksesit në rrjet në nivelet e tensionit 35 kV, 20/10/6 kV dhe 0.4 kV përkatësisht për të mundësuar kalimin e qetë të klientëve të lidhur me tensionin e mesëm nga tregu i rregulluar.

Për sa më sipër, OSSH sh.a. ka paraqitur përlogaritjet të ardhurave të kërkuara për nivele tensioni sipas arsyeve në vijim:

Përlogaritja e të ardhurës së kërkuar dhe tarifës në nivel tensioni ndërtohet mbi bazën e përlogaritjes së kostove të shërbimit për secilin nivel tensioni, evidentimi i saktë i të cilave për shkak të mungesës së të dhënave historike (procesi i ndarjes funksionale të shoqërisë pas ndarjes ligjore të saj sapo ka përfunduar) si edhe për shkak se për një pjesë të madhe të zërave, evidentimi i kostove direkte është i pamundur, ose kërkon kosto të larta të evidentimit që nuk janë efektive të kryhen sidomos për vitin e parë të aktivitetit. Pjesa më e madhe e zërave të kostove të shoqërisë nuk mund të evidentohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, prandaj për të alokuar kostot në mënyrë të arsyeshme shoqëria ka përdorur shpërndarje të kostove sipas raporteve në tabelën më poshtë:

Nr	Raportet e shpërndarjes	Niveli i Tensionit		
		35 kv	20/10/6 kv	0.4 kv
a	Sipas vlerës së aseteve	0.22%	12.17%	87.61%
b	Sipas konsumit të energjisë	1.77%	18.36%	79.87%
c	Sipas humbjeve	0.09%	6.98%	92.93%
d	Energji reaktive	2.88%	83.83%	13.29%

OSSH deklaroi se në përlogaritjen e tarifave të propozuar ka aplikuar peshën e secilit komponent bazuar mbi raportet e paraqitura si vijon:

Shpërndarja sipas raportit të furnizimit të energjisë në nivele tensioni:

- Shpenzimeve Operative (perjashto shpenzime të energjisë)
- Kapitalit të punës;
- Të ardhurave nga energjia reaktive;
- Korrigjimin e të ardhurave;

Shpërndarja sipas raportit në bazë të vlerës së aseteve në nivel tensioni

- Vlerës së aseteve;
- Amortizimin e akumuluar;
- Amortizimin e vitit;

Shpërndarja sipas raportit të shpërndarjes sipas humbjeve

- Kostot e humbjeve të energjisë në rrjet;
- Kostot e transmetimit për humbjet e energjisë në rrjet;
- Kostot e disbalancave të llogaritjes së konsumit të energjisë;

Në përfundim, tarifat e përditësuara dhe të paraqitura për miratim nga OSSH për secilin nivel tensioni, të përcjella në ERE me anë të shkresave nr. 11226/2, datë 04.02.2022 dhe shkresën 801/1, datë 22.02.2022, janë kërkuar si vijon:

- Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022 në tensionin 35 kV 2.62 Lekë/kWh
- Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022 në tensionin 20/10/6 kV 4.14 Lekë/kWh
- Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022 në tensionin 0.4 kV 7.37 Lekë/kWh
- Çmimi i faturimit të energjisë reaktive për vitin 2022 prej 1.92 lekë/kVARh

ERE, nëpërmjet korrespondencave të vazhdueshme, ka kërkuar dërgimin e kostove reale të shoqërisë për secilin nivel tensioni, bazuar në listat e llogarive të “Manualit të llogarive për qellime të rregullimit të shoqërive të licensuara në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar nga ERE. Evidentimi i këtyre kostove sidomos në mënyrë të veçantë i bazës së rregulluar të aseteve të shoqërisë për secilin nivel tensioni, është tejet i rëndësishëm për një shpërndarje të drejtë të kostove, ku vlera e secilit aset duhet të konsiderojë edhe përdorimin e tij në nivelet e mëposhtme të tensionit. Për këtë arsye, shoqëria OSSH sh.a. duhet të paraqiste në llogaritjet alokuese të saj edhe “Load Factor”, për të treguar raportet e ngarkesave që ka secili nivel tensioni. Në aplikim, OSSH ka përdorur disa koeficient për alokimin e kostove, të cilët në vetvete janë një mesatarizim i kostove për nivel tensioni dhe nuk mund të shërbejnë për alokimin e këtyre kostove, pasi nuk sigurojnë një shpërndarje proporcionale dhe kosto reflektuese.

Deri në paraqitjen e kostove reale për secilin nivel tensioni nga shoqëria OSSH sh.a, në përlllogaritjet e tarifës për nivel tensioni, kemi vlerësuar shpërndarjen në secilin vit të të ardhurave të munguara të shoqërisë, të cilat rezultojnë si diferencë e të ardhurave të realizuara nga tarifat në fuqi për periudhën 2015 – 2021, krahasuar me ato të cilat do të rezultonin sipas nivelit të rishikur të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për këtë periudhë.

Diferenca e të ardhurave nga përlllogaritja e të ardhurave të kërkuara për periudhën e mbetur të vitit 2022 dhe të ardhurave që do realizoheshin prej tarifës mesatare prej 4.79 lekë/kWh në fuqi me sasinë që pritet të lëvrohet në rrjetin e shpërndarjes për këtë periudhë, rezulton 7.6 miliard lekë (përfshirë dhe të ardhurat e munguara të përlllogaritura për periudhën Janar-Prill 2022 sikurse shprehur dhe më lartë).

Të ardhurat e kërkuara të përllogaritura ndaj sasive të energjisë elektrike që priten të lëvrohen në rrjetin e shpërndarjes 35 kV, 20/10/6 kV dhe 0.4 kV, rezultojnë si vijon:

35 KV	20/10/6 kv	0.4 kv	Total
158,769	4,232,494	29,630,296	34,021,559
102,336	1,060,413	4,612,980	5,775,729
1.55	3.99	6.42	5.89

Në përfundim, meqënëse për vlerësimin e treguesve dhe komponentëve të të ardhurave të kërkuara jemi bazuar në të dhënat e parashikuara prej OSSH për arsye të mosdërgimit të të dhënave faktike të vitit 2021 prej shoqërisë, ERE do të rishikojë shpenzimet operative dhe kapitale, si dhe sasinë e energjisë së lëvruar në rrjetin e shpërndarjes kundrejt vlerave reale të tyre, në përputhje me përcaktimet “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 182, datë 10.11.2017

Për gjithë sa më sipër, bazuar në nenin 16, nenin 19 gërma “c” dhe “i”, të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 244, datë 30.3.2016 “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.253, datë 24.4.2019 “Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjetik, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 584, datë 08.10.2021 “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 109, date 22.02.2006 "Per normen e lejuar te faktorit te fuqise”; Nenit 19 pika 1 gërma “c” dhe nenit 22 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedruave të ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016 “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike” miratuar me Vendimin Nr. 182, datë 10.11.2017 të Bordit të ERE-s; Vendimit Nr. 244, datë 26.11.2018 “Për miratimin e sistemit të njehësuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike”, i propozojmë Bordit të ERE-s:

1. Miratimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit, për periudhën 1 Maj – 31 Dhjetor 2022, si vijon:

a) Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV - 1.55 Lekë/kWh

*b) Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit
0.6 -20 kV - 3.99 Lekë/kWh*

*c) Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit
0.4 kV - 6.42 Lekë/kWh*

- 2. Miratimin e çmimit të aplikueshëm për faturimin e energjisë reaktive për periudhën
1 Maj – 31 Dhjetor 2022 prej 1.92 lekë/kVArh.**
- 3. Lënien në fuqi të Tarifës fikse të shërbimit për leximin "zero" prej 200 (Lekë/Muaj)**